

Monitorimi i Konventës mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

**Udhëzues për Vëzhguesit e të drejtave të njeriut
seria e trajnimeve profesionale nr 17**

New York dhe Gjenevë, 2010

Shënim

Emërtimet e përdorura dhe paraqitja e materialit në këtë botim nuk nënkuptojnë shprehjen e ndonjë opinioni nga ana e Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara në lidhje me statusin ligjor të ndonjë vendi, territori, qyteti, ose rajoni, ose të autoriteteve të tij, ose rreth përcaktimit të kufijve të tij.

HR/P/PT/17

Përkthimi në shqip i " Monitorimi i Konventës mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara - Udhëzues për Vëzhguesit e të drejtave të njeriut seria e trajnimeve profesionale nr 17 realizua me mbështetjen financiare të Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, (PNUD), www.undp.org.al, në kuadrin e projektit "Promovimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri; Program mbështetës për Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK)" që po zbatohet nga PNUD, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, www.mpcs.gov.al dhe Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, www.adrf.org.al. Tiranë, Nëntor 2010.

Përmbajtja

| | |
|---|----|
| Parathënie | 05 |
| I. Të kuptuarit e aftësisë së kufizuar si një çështje e të drejtave të njeriut..... | 07 |
| II. Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara | 12 |
| A. Nevoja për një konventë | 12 |
| B. Përcaktimi i aftësisë së kufizuar | 15 |
| C. Parimet e Konventës | 17 |
| D. Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara | 24 |
| E. Mekanizmat monitorues të Konventës | 30 |
| III. Monitorimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara: Përmbledhje | 33 |
| A. Roli qendror dhe përfshirja në monitorim e personave me aftësi të kufizuara..... | 33 |
| B. Identifikimi i personave që kanë përgjegjësinë për të përcaktuar shpërndarjen e detyrave dhe organizatat partnere | 34 |
| C. Ngritja e kapaciteteve të personave me aftësi të kufizuara dhe organizatat e tyre përfaqësuese | 36 |
| D. Monitorimi i dyanshëm i Konventës | 38 |
| IV. Monitorimi në praktikë | 40 |
| A. Mbledhja e të dhënave | 40 |
| B. Ligji dhe analizimi i të dhënave | 54 |
| C. Raportimi dhe ndjekja hap pas hapi..... | 63 |
| Bibliografia e zgjedhur | 65 |

Parathënie

Gratë, burrat dhe fëmijët me aftësi të kufizuara janë shpesh personat më të marginalizuar në të gjitha shoqëritë dhe ballafaqohen me sfida unike për të gëzuar të drejtat e tyre njerëzore. Për një kohë të gjatë mendohej se sfida të tilla janë pasojë e natyrshme dhe e pashmangshme e dëmtimeve të tyre fizike, mendore, intelektuale apo shqisore.

Miratimi dhe hyrja në fuqi e Konventës mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Protokolli i saj sfidojnë qëndrime të tilla dhe shënojnë një ndryshim të thellë në këndvështrimin për aftësinë e kufizuar. Në këtë Konventë, fokusi nuk është më perceptimi i "Gabimit" të personit ku dëmtimi shihet si një çështje mangësie apo sëmundjeje. Përkundrazi, kjo Konventë e trajton aftësinë e kufizuar si një "patologji të shoqërisë", që vjen si rezultat i dështimit të shoqërive në përfshirjen dhe akomodimin e ndryshimeve individuale. Shoqëritë kanë nevojë për ndryshime, jo individuale, dhe Konventa siguron rrugën për ndryshime të tilla.

Monitorimi i të drejtave të njeriut mund të luajë një rol kyç për të mbështetur Shtetet në implementimin efektiv të Konventës në nivel kombëtar dhe në fuqizimin e personave me aftësi të kufizuara për t'u bërë gjithnjë e më të vetëdijshëm për të drejtat e tyre, duke sjellë ndryshime pozitive në jetën e këtyre personave në të gjithë rajonet.

Puna për të drejtat e njeriut kërkon përgatitje, aftësi teknike dhe njohuri që të realizohet në mënyrë efektive. Qëllimi i këtij botimi është që të ndihmojë personat përgjegjës të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut dhe monitorues të tjerë të të drejtave të njeriut- përfshirë këtu vëzhgues nga qeveria, institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut dhe organizatat jo-qeveritare, për t'u angazhuar në monitorimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, në përputhje me Konventën. Ky publikim shpjegon ndryshimet mbi paradigmen që mbart Konventa dhe qëllimin, standardet dhe parimet e pranuar prej saj. Për më tepër, ajo propozon një metodologji për monitorimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe ofron këshilla të dobishme për çështje që duhen marrë në konsideratë kur punohet me personat me aftësi të kufizuara. Personat me aftësi të kufizuar kanë qenë historikisht të padukshëm në sistemin e

të drejtave të njeriut dhe janë anashkaluar kur është punuar për të drejtat e njeriut. Kjo nuk është më e pranueshme. Ky botim do të ndihmojë ata të cilët janë angazhuar në monitorimin e të drejtave të njeriut për të përfshirë në mënyrë efektive perspektivën e personave me aftësi të kufizuara në aktivitetet e tyre, jo vetëm duke i integruar personat me aftësi të kufizuara në monitorin e përgjithshëm të punës, por edhe duke i kushtuar vëmendje të veçantë monitorimit të situatave dhe faktit që personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë të drejtat e tyre.

Navanethem Pillay

Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut

I. Të kuptuarit e aftësisë së kufizuar si një çështje e të drejtave të njeriut

Është vlerësuar se rreth 650 milionë njerëz, 10 për qind e popullsisë së botës, kanë një aftësi të kufizuar. Tetëdhjetë për qind jetojnë në vende në zhvillimin. Disa gra, burra dhe fëmijë me aftësi të kufizuara janë plotësisht të integruar në shoqëri, dhe marrin pjesë duke kontribuar në mënyrë aktive në të gjitha fushat e jetës. Megjithatë, pjesa më e madhe përballen me diskriminim, përjashtim, izolimin madje edhe me abuzimin. Shumë persona me aftësi të kufizuara jetojnë në varfëri të skajshme, në institucione, pa mundësi arsimimi ose punësimi dhe përballen me një sërë faktorësh të tjerë të marginalizimit. Në disa vende atyre u është mohuar e drejta e pronës dhe konsiderohet normale që personave me aftësi të kufizuar t'u mohohet e drejta për të marrë vendime vetjake. Diskriminimi me të cilin ata përballen është gjerësisht i përhapur, përshkon kufijtë gjeografikë dhe prek njerëz të të gjitha sferave dhe shtresave shoqërore.

Hyrja në fuqi e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Protokollin e saj, në maj 2008 shënoi fillimin e një epoke të re në përpjekjet "për të promovuar, mbrojtur dhe për të siguruar që personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë të drejta të plota dhe të barabarta, liritë themelore të njeriut, dhe për të promovuar respekt për dinjitetin e tyre "(neni 1). Edhe pse personat me aftësi të kufizuara kanë të drejta të njëjta si gjithë të tjerët, është hera e parë që të drejtat e tyre janë përcaktuar tërësisht në një Konventë ndërkombëtare të detyrueshme.

Kjo Konventë pasqyron ndryshimin për mënyrën se si shihet aftësia e kufizuar dhe personat me aftësi të kufizuara.

Historikisht, aftësia e kufizuar është konsideruar si një gjendje personale, individuale.

Duke qënë një deficiet individual, statusi i "të qenit me aftësi të kufizuara " ka bërë që të mendohet si gjë e natyrshme që disa njerëz të mos ndjekin rregullisht një shkollë, të mos gjejnë një punë ose të mos marrin pjesë në jetën sociale. Kur aftësia e kufizuar është perceptuar në këtë mënyrë, përgjigjet/ reagimet e shoqërisë janë kufizuar vetëm në një nga dy rrugët e mëposhtme: individët mund të "shërohen" nëpërmjet mjekimeve ose rehabilitimit (kujdesi mjekësor), ose persona të caktuar mund të kujdesen për ta, nëpërmjet programeve bamirëse ose të mirëqenies. Sipas këtij modeli të vjetër, jeta e personave me aftësi të kufizuara varet nga profesionistët të cilët kontrollojnë vendime thelbësore të tilla si, në cilën shkollë do të shkojnë, çfarë mbështetje do të kenë dhe ku do të jetojnë.

I. Të kuptuarit e aftësisë së kufizuar si një çështje e të drejtave të njeriut

Gjatë dekadave të fundit, ka pësuar një ndryshim të rëndësishëm këndvështrimi mbi aftësinë e kufizuar. Fokusi nuk është më në atë çka është e gabuar tek personi. Aftësia e kufizuar vjen si pasojë e bashkëveprimit të individit me një mjedis që nuk akomodon nevojat individuale dhe kufizon ose pengon pjesëmarrjen e individit në shoqëri. Ky kufizim njihet si modeli social i aftësisë së kufizuar. Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara miraton këtë model dhe i mëshon njohjes së aftësisë së kufizuar si një çështje e të drejtave të njeriut.

Nga ky këndvështrim, rrethanat sociale, juridike, ekonomike, politike dhe mjedisore që veprojnë si barriera për ushtrimin e plotë të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara duhet të identifikohen dhe të tejkalohen.

Për shembull, marginalizimi dhe përjashtimi i tyre nga arsimimi nuk janë rezultat i paaftësisë së tyre për të mësuar, por i trajnimit të pamjaftueshëm të mësuesve ose klasave të paarritshme, përjashtimi i tyre nga tregu i punës mund të jetë për shkak të mungesës së transportit për në vendin e punës ose për shkak të

Për shembull, në vend që të pyetni: Çfarë është e gabuar me personat me aftësi të kufizuara?

Pyetni: Çfarë është e gabuar me shoqërinë? Çfarë kushtesh sociale, ekonomike, politike dhe / ose mjedisore duhen ndryshuar për të lehtësuar të gjithë personat me aftësi të kufizuara në mënyrë që të gëzojnë të gjitha të drejtat?

Për shembull, në vend të të pyetni: A është e vështirë për ju për të kuptuar njerëzit sepse ju jeni i shurdhër?

Pyetni: A është e vështirë për ju të kuptoni njerëzit, sepse ata nuk janë në gjendje të komunikojnë me ju?

Pyetjet e përshtatur nga: Michael Oliver, Politikat për aftësinë e kufizuar (Basingstoke Macmillan, 1990).

qëndrimeve negative midis punëdhënësve dhe kolegëve dhe mendimeve që një person me aftësi të kufizuara nuk është në gjendje për të punuar; pamundësia e tyre për të marrë pjesë në punë/ jetën publike mund të jetë si pasojë e mungesës së materialeve zgjedhore në format të aksesueshëm si p.sh Braille apo qendrave të votimit të papërshtatura fizikisht për njerëzit me aftësi të kufizuara.

Trajtimi i aftësisë së kufizuar nën këndvështrimin e të drejtave të njeriut, përfshin një evolucion në të menduarit dhe të vepruarit nga ana e shtetit dhe të gjithë sektorëve të shoqërisë, në mënyrë që personat me aftësi të kufizuara të mos

konsiderohen më përfitues të bamirësive ose objekte të vendimeve të tjerëve, por bartës të të drejtave. Ky kënvështrim bazohet në respektin, mbështetjen dhe diversitetin human, duke krijuar kushtet e favorshme për pjesëmarrjen e një game të gjerë personash, përfshirë personat me aftësi të kufizuara. Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të tyre nuk ka lidhje vetëm me shërbimet e ofruara për aftësinë e kufizuar. Ky këndvështrim lidhet me miratimin e masave për të ndryshuar qëndrimet dhe sjelljet që stigmatizojnë dhe marginalizojnë.

| Termet e mëposhtëm tregojnë ndryshimin midis konsiderimit të personave me aftësi të kufizuar si bartës të të drejtave dhe jo si objekte të bamirësisë: | |
|---|--|
| Përqasja e Bamirësisë | Përqasja për të drejtat e njeriut |
| Opsion | Detyrim |
| Kontrolli i jashtëm | Autonomi |
| Shfuqizim | Fuqizim |
| “Rregullim” i dobësisë | “Rregullim” i mjedisit |
| Kufizim aktiviteti | Lehtësim aktiviteti |
| Përçmim | Dinjitet |
| Varësi | Pavarësi |
| Diskriminim | Barazi |
| Institucionalizim | Përfshirje |
| | |

I. Të kuptuarit e aftësisë së kufizuar si një çështje e të drejtave të njeriut

| | |
|--------------|-----------------|
| Vecim | Integrim |
|--------------|-----------------|

Ky këndvështrim përfshin gjithashtu vënien në vend të politikave, ligjeve dhe programeve për të hequr pengesat dhe për të garantuar ushtrimin e të drejtave civile, kulturore, ekonomike, politike dhe sociale nga personat me aftësi të kufizuara. Për të ushtruar të gjitha të drejtat, duhet të zëvendësohen një sërë politikash, ligjesh dhe programesh që i kufizojnë ato, të tilla si: ligjet e imigrimit që ndalojnë hyrjen në një shtet të personave me aftësi të kufizuar; ligjet që ndalojnë personat me aftësi të kufizuara të martohen; ligje që lejojnë administrimin e trajtimit mjekësor të personave me aftësi të kufizuara pa pëlqimin dhe dijeninë e tyre, ligjet që lejojnë paraburgimin në bazë të paaftësisë mendore apo intelektuale, dhe politikave që mohojnë kujdesin mjekësor për një person me aftësi të kufizuara. Për më tepër, janë të nevojshme programe për rritjen e ndërgjegjësimit dhe mbështetjes sociale, të cilat ndryshojnë mënyrën se si një shoqëri vepron dhe për të tejkaluar pengesat që parandalojnë pjesëmarrjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri. Për më tepër, personat me aftësi të kufizuara duhet të kenë mundësi për të marrë pjesë plotësisht në shoqëri dhe për të kërkuar të drejtat e tyre.

II. Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

II. Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

A. Nevoja për një konventë

Thelbi i Konventës për të drejtat e njeriut që i paraprin Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara është njohja e të gjithë të drejtave për të gjithë njerëzit, përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara. Ndërkohë që Konventa të tilla ofrojnë potencial domethënës për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut për personat me aftësi të kufizuara, në fakt ky potencial nuk është arritur plotësisht.¹

Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara shënon fundin e një luftë të gjatë nga personat me aftësi të kufizuara dhe organizatat përfaqësuese të tyre, që këtyre personave t'u njihen plotësisht të drejtat e njeriut, luftë e cila filloi në 1981, me Vitin Ndërkombëtar të Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Plan-Veprimin të Programit Botëror në lidhje me Personat me Aftësi të Kufizuara, miratuar si rezultat i atij viti. Miratimi, në 1993, nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara i Rregullave Standarte mbi Mundësitë e Barabarta të Personave me Aftësi të kufizuara, raportet e Reporterëve Specialë mbi Aftësinë e kufizuar dhe e Komisionit mbi Parandalimin e Diskriminimit dhe Mbrojtjen e minoriteteve, si dhe një seri rezolutash nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut në 1998, 2000 dhe 2002, kontribuan në mënyrë të konsiderueshme për të hapur rrugën për një përjasje me fokus të drejtat e njeriut.

¹ Shih G. Quinn dhe T. Degener, të Drejtat e Njeriut dhe Aftësia e kufizuar: Përdorimi aktual dhe potenciali i ardhshëm i Konventës për të drejtat e njeriut në kontekstin e aftësisë së kufizuar për Kombet e Bashkuara (Neë York dhe Gjenevë, Kombet e Bashkuara, 2002) (HR/PUB/02/1). Ky studim arriti në përfundimin që organet qeveritare të Kombeve të bashkuara dhe shoqëria civile nuk i kishin përdorur instrumentet ekzistuese për të drejtat e njeriut dhe mekanizmat monitorues me gjithë potencialin e tyre për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Objektiva të tjerë të rëndësishëm ishin Rekomandimi i Përgjithshëm nr 18 (1991) për gratë me aftësi të kufizuara nga Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave, Komenti i Përgjithshëm Nr5 (1994) mbi personat me aftësi të kufizuara nga Komiteti mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore dhe miratimi i instrumenteve rajonale, të tilla si Konventa Ndër-Amerikane mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Personave me Aftësi të Kufizuara (1999).

Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara zëvendëson këto instrumente si traktatit më aktual, më i specializuar dhe bashkëkohor për të njohur të drejtat e personave me aftësi të kufizuar dhe për të sqaruar detyrimet që kanë Shtetet për të respektuar, mbrojtur dhe përmbushur këto të drejta. Në këtë mënyrë, kjo Konventë mishëron modelin e social dhe atë të të drejtave të njeriut për aftësinë e kufizuar.

II. Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

| |
|---|
| Nëntë instrumentet kryesore ndërkombëtare të të drejtave të njeriut |
| Konventa Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor |
| Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore |
| Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike |
| Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave |
| Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose poshtëruese |
| Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve |
| Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të gjithë Punëtorëve Emigrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre |
| Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara |
| Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e detyruar (nuk është ende në fuqi) |

B. Përcaktimi i aftësisë së kufizuar

Konventa nuk përfshin një përkufizim të aftësisë së kufizuar ose personave me aftësi të kufizuara në kuptimin e ngushtë, por më tepër jep disa udhëzime për konceptin e "aftësisë së kufizuar" dhe rëndësinë që ky koncept ka në këtë Konventë. Preambula në mënyrë të qartë tregon përpjekjet sociale për aftësinë e kufizuar, referuar modelit social të aftësisë së kufizuar, duke vënë në dukje se "aftësia e kufizuar është një koncept evolutiv dhe vjen nga bashkëveprimi midis personave me dëmtime dhe qëndrimeve e barrierave mjedisore që pengojnë pjesëmarrjen të plotë dhe efektive të këtyre personave në një shoqëri ku të gjithë janë të barabartë". Barrierat e jashme, të cilave ju referohemi si pengesa për subjektin në fjalë, si faktorë që favorizojnë aftësinë e kufizuar, përbëjnë një hap të rëndësishëm, por që nuk ka lidhje me nocionin që barazon aftësinë e kufizuar me funksione të limituara.² Prandaj, neni 1 thotë: "Në personat me aftësi të kufizuar përfshihen të gjithë ata persona që kanë dëmtime afat-gjatë fizike, mendore, intelektuale apo shqisore të cilat në bashkëveprim me barrierat e ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen të plotë dhe efektive të këtyre personave në një shoqëri ku të gjithë janë të barabartë" (e theksojmë). Nga ky këndvështrim, pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuar në shoqëri-të gjejnë një punë, të shkojnë në shkollë, të vizitohen te mjeku ose të votojnë-është e kufizuar ose personat janë të përjashtuar jo për shkak të dëmtimit që kanë, por për shkak të barrierave të ndryshme, të cilat mund të përfshijnë pengesa fizike por në disa raste edhe legjislacionin dhe politika të caktuara.

² Të shohim, për shembull, shpjegimin e konceptit të aftësisë së kufizuar të rezolutës së Rregullave Standarde mbi Mundësitë e Barabarta për Personat me Aftësi të Kufizuara (Asambleja e Përgjithshme rezoluta 48/96), sipas të cilës termi "aftësi e kufizuar" përmbledh një numër të madh të funksioneve të ndryshme të kufizuara që gjenden në popullatat në çdo vend të botës. Njerëzit mund të jenë me aftësi të kufizuara për shkak të një dëmtimi fizik, intelektual ose shqisor, kushteve mjekësore ose sëmundjeve mendore "(para. 17).

II. Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

Për personat me aftësi të kufizuara fizike këto pengesa mund të përfshijnë terrene jo të sheshta, lëvizja nga kati në kat, dyer të rënda ose korridore të ngushtë. Për shembull, një person që përdor karrike me rrota nuk mund të marrë pjesë në një takim në qoftë se dera e dhomës ku bëhet takimi është tepër e ngushtë për karriken, ose në qoftë se nuk ka hyrje të posaçme apo ashensor. Mungesa ose statandarte apo kode të paplota përsa i përket përshatshmërisë ndërtimore, mund të përbëjë një tjetër pengesë.

Konventa nuk përjashton përdorimin e përkufizimeve në legjislacionet kombëtare dhe, në fakt, përkufizimet mund të jenë të nevojshme në disa sektorë specifikë, të tilla si: sektorët e punësimit ose të sigurimeve shoqërore. Megjithatë, është e rëndësishme që përkufizime të tilla të pasqyrojnë modelin social të aftësisë së kufizuar të përcaktuar nga kjo Konventë dhe të rishikohen përkufizimet që bazohen në përshkrimet e një sërë dëmtimesh ose funksionesh të kufizuara.

Monitoruesit duhet të kontrollojnë nëse legjislacionin kombëtar: (a) evidenton që diskriminimi mund të ndodhë në lidhje me dëmtime mendore, intelektuale, ndijore ose fizike, (b) përfshin modelin social duke iu referuar aftësinë së kufizuar si rezultat i bashkëveprimit të dëmtimit të personit dhe barrierave të jashtme, (c) fokusohet në parandalimin e diskriminimit dhe promovimin e barazisë dhe jo në kategorizimin e aftësive të kufizuara.

C. Parimet e Konventës

Neni 3 i Konventës përcakton një sërë parimesh themelore për gjithëpërfshirjen. Ato udhëheqin interpretimin dhe implementimin e gjithë Konventës. Ato janë pika fillestare për të kuptuar dhe interpretuar të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, duke siguruar standartet mbi bazën e të cilave vlerësohe/ matet çdo e drejtë.

| |
|---|
| Parime të përgjithshme (neni 3) |
| Respektimi i personalitetit/ dinjitetit të lindur), autonomia individuale përfshirë lirinë për të bërë zgjedhje vetjake dhe pavarësia e personave. |
| Mos-diskriminimi |
| Pjesëmarrja e plotë dhe efektive dhe përfshirja në shoqëri. |
| Respekti për ndryshimin dhe pranimi i personave me aftësi të kufizuara si pjesë e diversitetit njerëzor dhe humanizmit. |
| Mundësi të barabarta |
| Përshtatshmëria |
| Barazia midis burrave dhe grave |
| Respekti për kapacitetet në zhvillim të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe respekti për të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara për të ruajtur identitetin e tyre. |

II. Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

Ku konsistojnë këto parime?

Dinjteti i lindur i referohet vlerave të çdo personi. Kur respektohet dinjteti i personave me aftësi të kufizuara, vlerësohen dhe formohen përvojat dhe mendimet e tyre, pa dëmtime fizike, psikologjike ose emocionale. Respekti për dinjtetin është mohuar kur, për shembull, punëtorët, të cilët janë të verbër, janë detyruar nga punëdhënësit e tyre të veshin një këmishë me fjalën "të verbër" të printuar në pjesën e shpinës.³

Një grua me aftësi të kufizuara në Indi raportoi shkeljen e të drejtës së saj për dinjtet, raportim i paraqitur më poshtë:

"Mbi të gjitha është sjellja e njerëzve, sidomos e meshkujve kur më duhet të dal vetëm dhe duhet të kapërcej rrugën për të shkuar diku. Njerëzit të cilët vijnë për të ndihmuar mua nuk mendojnë se janë duke bërë një vepër të mirë dhe gjithmonë më bëjnë të ndihem keq dhe prandaj unë nuk sillem mirë me ta. Për mua kjo është e pashmangshme, mua më duhet ndihma e dikujt për të kaluar rrugën dhe kjo është një mundësi për njerëzit përreth që ata të sillen në mënyrë të ulët, dhe nuk ka asgjë që unë mund të bëj në lidhje me këtë, sepse nuk mund t'ja dal pa ndihmën e dikujt kur jam në rrugë vetëm dhe kjo lloj eksperience është diçka me të cilën unë jam përballur në disa raste në jetën time, jo një apo dy herë. "

Burimi: "Monitorimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara- Raporti: Andhra Pradesh, India "(Disability Rights Promotion International, 2009), gjendet në ëëë.yorku.ca / drpi

³ Ky shembull është marrë nga intervistat e kryera në Filipine, si pjesë e një projekti për Promovimin e të Drejtave për personat me Aftësi të Kufizuar Maykapansanan International (DRPI) dhe Katipunan ng Maykapansanan sa Pilipinas, Inc (KAMPI) për monitorimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në atë vend. Intervistat kontribuan në "Monitorimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara: Raporti paraprak Filipine ", që gjendet në: ëëë.yorku.ca / drpi / resources.html

Autonomia individuale nënkupton përgjegjësi për jetën e gjithsecilit dhe liri për të bërë zgjedhjet vetjake. Respekti për autonominë individuale të personave me aftësi të kufizuara do të thotë se personat me aftësi të kufizuara kanë, në kuadër të barazisë me të tjerët, mundësi zgjedhjeje në jetë, janë subjekt për ndërhyrje minimale në jetën e tyre private dhe mund të marrin vendime vetjake, me përkrahjen e duhur kur nevojitet. Ky parim përshkon Konventën dhe mbështet shumë nga liritë që ajo njeh, të tilla si liria nga ndërhyrje mjekësore jo-konsensuale dhe faktin që kujdesi shëndetsor duhet të sigurohet në bazë të pëlqimit dhe dijenisë së personit në fjalë. Nga ky këndvështrim, për shembull, një personi me aftësi të kufizuara mendore duhet t'i ofrohen një sërë mundësish për kujdesin e shëndetit mendor të tilla si, psikoterapia, këshillimi, mbështetje dhe medikamente psikiatrike, dhe ai duhet të ketë lirinë për të bërë një zgjedhje në bazë të preferencave personale. Po kështu, një i mbijetuar nga një minë tokësore me një dëmtim fizik duhet të pajiset me mjete që lehtësojnë lëvizjen personale të tij ose të saj në mënyrë që ai ose ajo mund të gëzojë sa më shumë pavarësi që të jetë e mundur.

Parimi i **mos-diskriminimit** nënkupton se të gjitha të drejtat janë të garantuara për të gjithë pa dallim, përjashtim ose kufizim bazuar në aftësinë e kufizuar ose racën, ngjyrën, gjininë, gjuhën, fenë, apo bindjet politike, origjinën sociale apo kombësinë, pasurinë, vendlindjen, moshën, ose ndonjë status tjetër. Diskriminimi në bazë të aftësisë së kufizuar nënkupton çdo dallim, përjashtim ose kufizim që ka si qëllim dëmtimin ose zhvleftësimin e të njohurit, të gëzuarit ose të ushtruarit nga personat me aftësi të kufizuara, në barazi të plotë me të tjerët, e të gjithë të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, përfshirë përshtatjen e nevojshme. Diskriminimi ndodh, për shembull, kur një grua nuk lejohet të hapë një llogari bankare për shkak se aftësia e kufizuar nuk e lejon atë të menaxhojë paratë e saj.⁴

⁴ Ky shembull është marrë nga intervistat e kryera në Kenia, si pjesë e një projekti nga DRPI, të Unionit Afrikan të të Verbërve, Unionit e të Verbërve në Kenia dhe Qendrës për të Drejtat e personave me Aftësi të Kufizuara, e Arsimit dhe Avokatisë për monitorimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në atë vend. Intervistat kontribuan në "Gjendja e të drejtave të njerëzve me aftësi të kufizuara në Kenia (2007): Raporti ", gjendet në: [www.yorku.ca / drpi / Kenya.html](http://www.yorku.ca/drpi/Kenya.html)

II. Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

Diskriminim ndodh edhe në rastin kur një burri, të cilit iu ofrua një punë pas një interviste, më vonë i thuhet se duhet të shkojë në shtëpi dhe të presë për një konfirmim me shkrim nga administrata, pasi punëdhënësi kupton se ky person ka një dëmtim vizual dhe duhet t'i mbajë librat shumë afër syve. Konfirmimi nuk mbërrin kurrë dhe personi në fjalë humbet vendin e punës.⁵ Personat me aftësi të kufizuara mund të përjetojnë forma të shumta të diskriminimit, për shembull, një grua me aftësi të kufizuara mund të diskriminohet si në bazë të seksit ashtu dhe në bazë të aftësisë së kufizuar. Njohja e parimit të mosdiskriminimit në nenin 3 nënvizon rëndësinë e diskriminimit në të gjitha format e tij.

Barazia nënkupton krijimin e kushteve shoqërore që respektojnë ndryshimin, adresojnë disavantazhet dhe sigurojnë që gratë, burrat, vajzat dhe djemtë të jenë pjesëmarrës të barabartë. Barazia është mohuar, në rastin kur një vajze me aftësi të kufizuara i privohet e drejta e shkollimit nga prindërit e saj. Pavarësisht notave të saj të mira, prindërit vendosin se nuk është nevoja të shpenzojnë para për arsimimin e saj për shkak të aftësisë së kufizuar.⁶ Arritja e barazisë shpesh kërkon të merren disa masa të tjera shtesë, të tilla si dhënia e ndihmës për personat me aftësi të kufizuar psikosociale ose intelektuale për t'i mbështetur ata në marrjen e vendimeve dhe në ushtrimin e të drejtave ligjore në barazi të plotë me të tjerët.

Përshtatshmëria (akomodimi i i arsyeshëm) (neni 2)

"Përshtatshmëria/ akomodimi i arsyeshëm" nënkupton të gjitha modifikimet dhe rregullimet e nevojshme, duke përjashtuar ngarkesa joproportionale dhe të panevojshme, me përjashtim të ndonjë rasti të veçantë, për të siguruar që personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë ose të ushtrojnë në barazi të plotë me të tjerët të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut (Neni 2).

"Përshtatshmëria" ka të bëjë me ndryshimin e një rregulli, praktike, kushteve ose kërkesave në mënyrë që të merren parasysh nevojat specifike të një individi me aftësi të kufizuara, me qëllim që ky person të marrë pjesë plotësisht në shoqëri dhe në mënyrë të barabartë. Në vendin e punës, përshtatja mund të përfshijë marrjen ose adaptimin e softëare-ve dhe tastierave specifike për një punonjës me dëmtim vizual, trajnimeve ose

dhënien e kohës shtesë për të përfunduar një detyrë. Në arsimim, përshtatja mund të kërkojë përvetësimin e mënyrave alternative për të plotësuar kërkesat e lëndës, ndihmë nga tutori ose teknologji mbështetëse.

Punëdhënësit, institucionet arsimore, ata që ofrojnë shërbime dhe të tjerët kanë një detyrim ligjor për të siguruar përshtatjen e duhur. Për të vendosur nëse një kompani apo një shkollë ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të akomoduar një punonjës ose një nxënës me aftësi të kufizuara, koncepti i " ngarkesës joproportionale të panevojshme "është kyçi. Për të përjashtuar ligjërisht akomodimin, punëdhënësi ose shkolla duhet të provojë se akomodimi për nevojat e një individi mund të jetë një barrë e panevojshme ose disproporcionale në organizimin e punës duke marrë parasysh faktorë të tillë si shëndetin, sigurinë ose kostot.

5 Shih shënimin 4.

6 Shih shënimin 4.

II. Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

Koncepti i ***pjesëmarrjes dhe përfshirjes së plotë, efektive dhe aksesit*** nëkupton që shoqëria, si ajo publike dhe ajo private, është organizuar në mënyrë të tillë që të gjithë njerëzit të marrin pjesë plotësisht.

Përfshirja e plotë në shoqëri nëkupton që personat me aftësi të kufizuara janë njohur dhe vlerësuar si pjesëmarrës të barabartë me të tjerët. Nevojat e tyre janë integruar si pjesë e rendit shoqëror dhe ekonomik dhe nuk janë identifikuar si "specifike". Për të arritur integrim dhe akses të plotë në një shoqëri, duhet të hiqen barrierat fizike dhe sociale. Për shembull, pjesëmarrje e plotë, efektive dhe përfshirje nëkupton që procesi i zgjedhjeve politike të mos përjashtojë personat me aftësi të kufizuara, duke siguruar, për shembull, formate të vlefshme të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore, që janë të lehta për t'u kuptuar dhe përdorur. Koncepti i pjesëmarrjes dhe përfshirjes, lidhet me modelin universal, i cili është perkufizuar në Konventë si "dizenjim/projektim i produkteve, mjediseve, programeve dhe shërbimeve që të jenë të përdorshme nga të gjithë njerëzit me shtrirjen më të gjerë të mundshme, pa patur nevojën për adaptim ose modele specifike "(neni 2). Me fjalë të tjera, në këtë fazë duhen marrë parasysh nevojat e të gjithë anëtarëve të shoqërisë, në mënyrë që të sigurohemi se nuk do të lindë nevoja për përshtatje specifike më vonë.

Respekti për ndryshimin ka të bëjë me pranimin nga të tjerët parë në kontekstin e mirëkuptimit reciprok. Kjo përfshin pranimin e aftësisë së kufizuar si pjesë e diversitetit të njeriut dhe të humanizmit. Pavarësisht nga disa ndryshime të dukshme, të gjithë njerëzit kanë të drejta dhe dinjitet të njëjtë.

Në këtë mënyrë, për shembull, para se të largohet autobusi nga një stacion, shoferi duhet t'i japë kohën e mjaftueshme një djali me aftësi të kufizuara fizike të ngrihet nga stoli në strehën e stacionit, të hipë në autobus dhe të zërë një vend. Në këtë mënyrë shoferi i autobuzit sigurohet se të gjithë pasagjerëve ju ofrohet transport i sigurt dhe cilësor, dhe merr parasysh për orarin e autobusit edhe faktorë të ndryshëm, duke përfshirë edhe kërkesat e personave me aftësi të kufizuara si dhe të përdoruesve të tjerë të transportit publik. E rëndësishme është, që kjo Konventë nuk ka si qëllim të parandalojë aftësinë e kufizuar-që është një çështje që lidhet me përpjekjet e mjekësisë, por më tepër synon të parandalojë diskriminimin bazuar në aftësinë e kufizuar. Fushatat për të parandaluar aksidentet dhe për të promovuar lindjen e sigurt të fëmijëve dhe mëmësinë përkojnë me ato të shëndetit dhe sigurisë publike. Megjithatë, kur fushata të tilla promovohen në kontekstin e personave me aftësi të kufizuara, aftësia e kufizuar perceptohet në

aspektin negativ, duke zhvendosur vëmendjen nga respekti për ndryshimin dhe diversitetin, si dhe nga lufta kundër diskriminimit që është fokusi kryesor i modelit për të drejtat e njeriut.

Këto parime të përgjithshme janë thelbi i Konventës dhe janë themelore për monitorimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

II. Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

D. Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara

Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara përfshin trajtimin e të gjithë të drejtave të njeriut duke mbuluar plotësisht spektrin civil, të drejtat kulturore, ekonomike, politike dhe sociale. Konventa nuk përcakton të drejta të reja për personat me aftësi të kufizuar, përkundrazi, ajo shtjellon se çfarë nënkuptojnë të drejtat ekzistuese të njeriut për personat me aftësi të kufizuar dhe sqaron detyrimet e shteteve palë për të mbrojtur dhe promovuar këto të drejta. Në mënyrë që të sigurohet një mjedis i favorshëm për përmbushjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, kjo Konventë përfshin gjithashtu nene mbi rritjen e ndërgjegjësimit, përgjegjshmërisë, përshtatshmërisë, sigurinë ndaj emergjencave civile, aksesit për drejtësi, lëvizshmërinë personale, aftësimin, rehabilitimin, si dhe mbledhjen e të dhënave dhe statistikave.⁷

⁷ "Raporti i Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut në procesin e implementimit të rekomandimeve të përfshira në studimin për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara "(A/HRC/4/75, paragrafi 19).

Nenet nga 10 deri në 30 përfshijnë të drejtat e garantuara të personave me aftësi të kufizuara

Neni 10 - E drejta për jetën

Neni 11 – Menaxhimi i emergjencave civile

Neni 12 - Barazia para ligjit

Neni 13 - Aksesimi për drejtësi

Neni 14 - Liria dhe siguria e personit

Neni 15 - Mbrojtja nga torturat, trajtimet çnjerëzore, poshtëruese ose ndëshkimet mizore

Neni 16 - Mbrojtja nga shfrytëzimi, dhuna dhe abuzimi

Neni 17 - Mbrojtja e integritetit të personit

Neni 18 - Liria e lëvizjes dhe mbrojtja e kombësisë

Neni 19 – E drejta për të jetuar në mënyrë të pavarur dhe përfshirja në komunitet

Neni 20 - Lëvizshmëria personale

Neni 21 - Liria e mendimit, shprehjes dhe të drejtës për t'u informuar

Neni 22 - Respekti për jetën private

Neni 23 - Respekti për shtëpinë dhe familjen

Neni 24 – E drejta për edukim

Neni 25 – E drejta për të gëzuar shëndet

Neni 26 - Aftësimi dhe rehabilitimi

Neni 27 - Puna dhe punësimi

Neni 28 - Standartet bashkëkohore të jetesës dhe mbrojtja sociale

Neni 29 - Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike

Neni 30 - Pjesëmarrja në jetën kulturore, argëtuese dhe sportive

II. Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

Për të ilustruar se sa të rëndësishme janë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në përballjen e situatave specifike, të merren në konsideratë shembujt e mëposhtëm gjatë procesit të monitorimit të Konventës:

> E drejta e barabartë para ligjit, kërkon, ndër të tjera, eliminimin e konceptit të aftësisë së kufizuar për të privuar dikë nga e drejta e asistencës juridike-për shembull, eliminimi i praktikës së emërimit të kujdestarëve si personat përgjegjës për të marrë vendime në emër të personave të me aftësi të kufizuara dhe, në vend të kësaj, t'i mbështetësh personat me aftësi të kufizuara në mënyrë që ata të mund të marrin vendimet e tyre;

> E drejta për lirinë dhe sigurinë e personit kërkon, ndër të tjera monitorimin e institucioneve psikiatrike dhe institucioneve të tjera të kësaj natyre për të siguruar se askush nuk është vendosur atje bazuar në aftësinë e kufizuar, përfshirë aftësinë e kufizuar mendore dhe intelektuale, përveç se me pëlqimin dhe vetëdijen e tyre;

> Mbrojtja nga torturat kërkon, ndër të tjera, të shqyrtohet nëse institucionet përdorin praktika dhe trajtime të tilla si terapia e elektroshokut dhe shtretër kafaze për personat me aftësi të kufizuar, ose përdorimin e trajtimeve mjekësore për qëllim korrigjimin e aftësisë së kufizuar kundër vullnetit të personit;

> Liria e lëvizjes kërkon, ndër të tjera, të shqyrtohet nëse Shteti i ka pajisur me dokumente të veçanta udhëtimi personat me aftësi të kufizuar;

> E drejta për arsimim kërkon, ndër të tjera, të shqyrtohet nëse nxënësit dhe studentët me aftësi të kufizuar nuk janë përjashtuar nga sistemi i përgjithshëm i arsimit bazuar në aftësinë e kufizuar të tyre, që është siguruar nga sistemi i përgjithshëm i edukimit akomodimi i posaçëm për kërkesat e nxënësve dhe që janë siguruar masa efektive mbështetëse për të rritur zhvillimin akademik dhe social me qëllim përfshirjen;

> E drejta për të gëzuar shëndet kërkon, ndër të tjera, jo vetëm shqyrtimin nëse ka

akses për përdorimin e ilaçeve esenciale, por edhe nëse trajtimet janë dhënë bazuar në vullnetin dhe vetëdijen e personave me aftësi të kufizuara;

> E drejta për punë kërkon, ndër të tjera, të shqyrtohen nëse ligjet e punës ndalojnë diskriminimin në vendin e punës dhe t'u kërkojë punëdhënësve të ndërmarrin hapa pozitivë për të siguruar ndërtesa të përshtatura, si dhe teknologji të posaçme të tilla si kompjuteri dhe interneti për ata persona me aftësi të kufizuara që mund t'u nevojitet;

> E drejta për standarde bashkëkohore jetese kërkon, ndër të tjera, një shqyrtim të programeve sociale dhe kornizave politike, strategjive kombëtare për reduktimin e varfërisë, planeve kombëtare të zhvillimit dhe projekteve, të tilla si projekte që lidhen me Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit, për t'u siguruar që të përfshihet promovimi dhe mbrojtja e të drejtës për t'u ushqyer, për t'u veshur dhe strehuar dhe të drejta të tjera të personave me aftësi të kufizuara;

> E drejta për të marrë pjesë në jetën publike dhe politike kërkon, ndër të tjera, monitorimin e zgjedhjeve për të siguruar formate të aksesueshme të materialeve zgjedhore (të tilla si materialet e shkruara në Braille dhe reklamat televizive me gjuhën e shenjave) dhe të dhomave të votimit në mënyrë që këta persona t'i përdorin me lehtësi;

> E drejta për të marrë pjesë në jetën kulturore kërkon, ndër të tjera, të shqyrtohet gjuha e shenjave dhe kultura për personat që nuk dëgjojnë, mbrojtja e të drejtës së autorit të mos pengojë asimilimin e materialeve të tjerë kulturorë përfshirë librat e incizuar,

Të drejtat civile, kulturore, ekonomike, politike dhe shoqërore janë të pandashme, të ndërvarura dhe të ndërlidhura. Kjo ndërvarësi është e rëndësishme për të monitoruar të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Për shembull, monitorimi që bëhet nga institucione të caktuara, monitoron faktin nëse personat privohen nga liria bazuar në ekzistencën e një aftësie të kufizuar (të drejtën për lirinë dhe sigurinë e personit), nëse personat janë objekt i një trajtimi mjekësor pa pëlqimin dhe vetëdijen e tyre (të drejtën për të gëzuar shëndet, për integritet fizik, mendor dhe të mbrohen nga torturat), si dhe personat në institucione kanë ushqim të përshtatshëm, veshmbathje, kushte sanitare dhe kështu me radhë (të drejtën për standard bashkëkohor të jetesës).

Në lidhje me të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, Konventa

mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, riafirmon detyrimin e Shteteve për të zbatuar në mënyrë rigorozë këto të drejta, që tashmë njihen si neni 2 i Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore dhe neni 4 i Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve. Njohja e plotë e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore, që mund të kufizohet nga burime të caktuara, balancohet nga kërkesa për marrjen e masave që të vihen në dispozicion të Shtetit maksimumi i burimeve të vlefshme dhe kur është e nevojshme në kuadër të bashkëpunimit Ndërkombëtar (Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, nenet 4 (2) dhe 32).

Aspekte të ndryshme për realizimin rigoroz të të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore janë të rëndësishme për monitorimin⁸:

Diskriminimi në çdo fushë, përfshi aftësinë e kufizuar, është gjithmonë i ndaluar, pavarësisht nga niveli i arritjeve/realizimit të të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore;

> Shtetet kanë detyrim imediat (të menjëhershëm), për të siguruar të paktën, nivelin minimal jetësor, për të siguruar çdo të drejtë ekonomike, sociale dhe kulturore;

> Shtetet kanë detyrimin për të ndërmarrë hapa rigorozë në drejtim të njohjes së këtyre të drejtave. Një shtet, për shembull, mund të hartojë një plan-veprimi i cili duhet të përfshijë: (a) një periudhë kohore për implementimin e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore; (b) përcaktime të sakta të arritjeve të realizimit të këtyre të drejtave brenda kufijve të mirëpërcaktuar kohorë, dhe (c) treguesit e suksesit për detyrimet e Shteteve palë.

⁸ Shih Komiteti mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Komenti i Përgjithshëm Nr 3 (1990)

II. Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

Njohja e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore

Neni 4 (2) thekson:

Në lidhje me të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, çdo Shtet-Palë duhet të ndërmarrë masa për të vënë në dispozicion numrin maksimal të burimeve informuese në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, me qëllim që të arrihet njohja e plotë e këtyre të drejtave, pa paragjykuar detyrimet që përfshihen në Konventën aktuale që kanë hyrë menjëherë në fuqi konform ligjeve ndërkombëtare.

> Shtetet ndalohen të ndërmarrin hapa regresive ose masa që pengojnë këta persona të gëzojnë të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore.

E. Mekanizmat monitorues të konventës

Konventa përfshin njëkohësisht mekanizma monitorues kombëtar dhe ndërkombëtar.

Në rang kombëtar pika 33 identifikon tre mekanizma që janë të përshtatshëm për zbatimin dhe monitorimin e konventës.

Së pari, shtetet duhet të përcaktojnë një ose më shumë pika kryesore brenda qeverisë për çështjet që kanë lidhje me implementimin; së dyti shtetet duhet ti japin rëndësi vendosjes ose përcaktimit të një mekanizmi koordinues brenda qeverisë për të lehtësuar veprimet përmes sektorëve dhe niveleve të ndryshme; së treti shtetet duhet të vendosin ose përcaktojnë një strukturë që përfshin një ose me shume mekanizma të pavarur, për të ndihmuar, mbrojtur dhe monitoruar zbatimin e Konventës.

Në nivel ndërkombëtar, neni 34 vendos krijimin e Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të kufizuar, një Komitet ky me ekspert të pavarur me funksione të ndryshme. Fillimisht, në bazë të raporteve periodike të marra nga shtetet dhe palë të tjera të interesuara si mekanizmat monitorues kombëtar dhe organizatave të shoqërive civile, Komiteti angazhohet në një dialog konstruktiv me shtetet për zbatimin e Konventës, dhe konkludon në observacione dhe rekomandime për tu ndjekur për dhe vepruar për të përmirësuar dhe forcuar këtë zbatim. Së dyti Komiteti cakton ditë për diskutim të përgjithshëm, të hapura për publikun, gjatë të cilave diskutohen çështje me interes të përgjithshëm të ngritura nga Konventa. Së treti, Komiteti mund të nxjerrë qëndrime autoritare, të njohura si komente apo vërejtje të përgjithshme, të qartësojë kushte ose masa specifike në Konventë ose çështje të ngritura gjatë zhvillimit të Konventës. Së katërti, Protokolli Opsional i jep Komitetit autoritetin të marrë ankesat, të njohura dhe si komunikime nga individë që pretendojnë shkeljen e ndonjërit prej kushteve të Konventës nga ndonjë shtet që ka ratifikuar apo miratuar Protokollin. Komiteti do të paraqesi pershtypjet e veta pasi të ketë marrë parasysh ankesën e hetuar nderkohe edhe nga shteti në fjalë. Së pesti, Protokolli gjithashtu e siguron Komitetin me një mundësi për të ndër marrë hetime në shtetet anëtare, nëq merr informacion të besueshëm që tregon dhunime të rënda apo sistematike të Konventës.

Monitoruesit e të drejtave të njeriut⁹ duhet të vihen në dijeni dhe paralajmërohen për këto mekanizma dhe për funksionimin e tyre. Aktivitetet monitoruese mund:

- Tu sigurojë mekanizmave të moniroimit kombëtar informacion mbi gjëndjen e zbatimit të Konventës.

- Ti sigurojnë Komitetit informacion për dialogun e saj konstruktiv me Shtetet.

⁹ Për qëllime të këtij udhëzuesi “monitoruesit e të drejtave të njeriut” përfshijnë nëpunës të të drejtave të njeriut të Kombeve të Bashkuara si staf edhe në organizata të tjera ndërqeveritare, rajonale, shoqëri civile, institucione kombëtare të të drejtave të njeriut, mbrojtës të të drejtave të njeriut, si dhe organizata apo individë të tjerë të përfshirë në monitorimin e të drejtave të njeriut

II. Konventa e të Drejtave të Personave me Aftësi të kufizuar.

- Të identifikojnë shkelje të mundshme të të drejtave të individëve nën konventë, gjë që mund të formojë bazat për një komunikim me Komitetin në bazë të Protokollit Opsional nëqoftëse shteti që ka lidhje me çështjen e ka ratifikuar apo miratuar këtë protokoll.
- Të identifikojë informacione të besueshme për dhunim të rëndë ose sistematik të Konventës, gjë e cila mund të nxisin Komitetin për të ndërmarë një hetim bazuar në Protokollon..Opsional, nëqoftëse shteti që ka lidhje me çështjen e ka ratifikuar atë.
- Të ndjekë rekomandimet e mekanizmave monitorues kombëtr dhe Komitetit për të forcuar zbatimin e Konventës.

III. Monitorimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar: Përmbledhje.

Raportet dhe relacionet e fuqishme të të bazuara në evidence, të shteteve, institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut, organizatave të aftësisë së kufizuar, grupeve të tjera shoqërisë civile si edhe zyrat e Kombeve e Bashkuara, me një mandat të posaçëm do të kontribuojnë për të siguruar që të drejtat e njeriut të garantuara në Konventë, do të kthehen në vëprime konkrete dhe ndryshim real në jetët e personave me aftësi të kufizuar. Përpara se të merret në konsideratë mënyra apo modaliteti i monitorimit, është e rëndësishme të kihen parasysh faktorët e mëposhtëm që duhet të drejtojnë ose udhëheqin të gjitha aktivitetet monitoruese.

A. Roli qëndror dhe përfshirja në monitorim e personave me aftësi të kufizuar

Personat me aftësi të kufizuar dhe organizatat e tyre përfaqësuese ¹⁰ luajnë një rol integral apo përbërës në formulimet dhe bisedimet e Konventës nën parrullën "Asgjë për ne, pa ne!" Konventa pranon që ky rol duhet të vazhdojë të bëjë që shtetet pjesëmarrëse të "konsultohen drejtpërdrejt" dhe "të përfshijnë aktivisht" personat me aftësi të kufizuar në procesin e vendimmarrjes që ka lidhje me ta. (art. 4 (3)).

Në veçanti, Konventa kërkon që "shoqëria civile e veçanërisht personat me aftësi të kufizuar dhe organizatat e tyre përfaqësuese duhet të përfshihen dhe të marrin pjesë plotësisht në procesin monitorues" (art. 33 (3)). Kjo nënkupton si procesin ashtu edhe substancën. Në termat e procesit, personat me aftësi të kufizuar mund të përfshihen në aktivitetet monitoruese, për shembull duke pasur persona me aftësi të kufizuar pjesë /brenda monitoruesve.

¹⁰ Vini re se disa herë përfaqësuesit e organizatave të personave me aftësi të kufizuar vetidentifikohen si "Organizata të personave me aftësi të kufizuar" ose përdorin shkurtimisht DPO/ "OPAK"

Në termat e substancës, zërat dhe eksperiencat e personave me aftësi të kufizuar duhet të jenë thelbësore në raportet monitoruese, duke pranuar faktin që personat me aftësi të kufizuar janë ekspert në situatën e tyre.

Gjithashtu është e rëndësishme të sigurohet që përpjekjet për të monitoruar situatën e të drejtave të njeriut për personat me aftësi të kufizuar të mos kontribuojë në marginalizimin e mëtejshëm të këtyre personave në një grup te caktuar. Monitorimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar duhet të ketë një fokus ndër nërsektorial dhe ndërshoqëror.

Kjo do të thotë që monitorimi duhet të përfshijë burrat, gratë, vajzat dhe djemtë brenda gjithë spektrit të aftësisë së kufizuar, duke përfshirë fizike, mendore, intelektuale ose dëmtimet ndijore dhe nga të gjitha mjediset socio-ekonomike dhe etnike, grupmoshat dhe pozitat shoqërore në jete. Për shembull, ai duhet të arijë të përfshijë ata që janë të varfër, të pastrehë ose të institucionalizuar.

B. Identifikimi dhe planifikimi (hartifikimi) i aktorëve përgjegjës dhe organizatave partnere.

Një hap i parë i rëndësishëm për ata që ngarkohen në monitorimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar është të identifikojnë hartën e aktorëve të ndryshëm në procesin monitorues. Monitoruesit duhet ti japin rëndësi identifikimit të institucioneve përgjegjës, duke përfshirë ministrinë, me përgjegjësitë që kanë të bëjnë me personat me aftësi të kufizuar, si psh. Ministria e Drejtësisë, përfaqësuesit ligjor-gjykatat e prokurorinë, departamentet dhe ministrinë për mbrojtjen sociale, punësimin, kulturën, sportin gjithashtu dhe shendetin. Falë referencave të Konventës tek subjektet private, monitoruesit duhet gjithashtu të marrin në konsideratë shoqatat e punësimit dhe sindikatat si partnerë potencial në monitorim, madje edhe aktorët që kanë përgjegjësi për respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar. Mbani parasysh qëllimin për të pasur një qasje shumësektoriale sa i përket kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar apo prejarshjes së tyre sociale gjatë procesit të identifikimit të organizatave të personave me aftësi të kufizuara, gjatë monitorimit. P.sh disa organizata kanë një antarësi të PAK të kategorive të ndryshme, të tjerë do të përfaqësojnë persona me një lloj të veçantë dëmtimi ose aftësi të kufizuara si psh. dëmtimet pamore ose dëmtimet psiko-sociale, apo grupe të veçanta njerëzish si gratë me aftësi të kufizuar e veteranët e luftës. Monitoruesit duhet gjithashtu të vendosin dhe të promovojnë një komunikim në rrjet me nje shtrirje te gjere partnerësh plotësues. Këta partnerë ose pjestar vijnë nga fusha dhe sektorë të ndryshëm (duke përfshirë, universitete,

institute kërkimi, OJQ, sindikata, grupe profesionistësh, organizata ndërqeveritare, dhe fokusohen në persona të ndryshëm (duke përfshirë organizata që punojnë me gratë, fëmijët dhe vendas). The Inter-AgencySupport Group, duke përfshirë departamentet e Kombeve e Bashkuara, agjensitë, mjetet financiare dhe programet, synon të koordinojnë punën e Kombeve të Bashkuara në Konventë.¹¹ Monitoruesit duhet gjithsesi të marrin në konsideratë kontaktin me subjekte të tjera të Kombeve të Bashkuara ose Bankën Botërore qoftë si partnerë në monitorim apo si burime informacioni.

¹¹ The Inter-Agency Support Group për konventën për të drejtat e prsonave me aftësi të kufizuar (IASG) është themeluar nga Shefi i Bordit Ekzekutiv të Kombeve të Bashkuara në Shtator 2006. IASG është një mekanizëm për bashkëpunim ndërkombëtar në mbështetje të promovimit dhe zbatimit të Konventës dhe Protokollit të saj Opsional. Anëtarët e saj përfshijnë Komisionerët e Lartë të Zyrës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (OHCHR), Departamentin e çështjeve Ekonomike dhe Sociale (DESA), Programin për Zhvillim te Kombeve të Bashkuara (UNDP), Fondai i Fëmijëve të Kombeve të Bashkuara (UNICEF), Organizatën Botërore të Shëndetit (ËHO), Organizatën Ndërkombëtare të Punës (ILO), Fondi i Popullsisë së Kombeve të Bashkuara (UNFPA), Aktin e Minierave të Kombeve të Bashkuara dhe Komisionerët e Lartë të Kombeve të Bashkuara për refugjatët (UNHCR).

III. Monitorimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar: Përmbledhje.

C. Ndërtimi i kapaciteteve të personave me aftësi të kufizuar dhe organizatave të tyre përfaqësuese

Në shumë raste, angazhimi me organizatat e personave me aftësi të kufizuar (OPAK) do të nënkuptojë gjithashtu ndërtimin e kapaciteteve të personave me aftësi të kufizuar në këto organizata, për të kuptuar parimet dhe konceptet e të drejtave të njeriut. Me fjalë të tjera, ndërtimi i kapaciteteve është pjesë dhe plotësuese e punës monitoruese. Në të gjitha rastet aktivitetet e ndërtimit të kapaciteteve duhet të jenë plotësisht të arritshme tek të gjithë. Partnerët e organizatave të personave me aftësi të kufizuar (OPAK) dhe anëtarët e tyre duhet të jenë në gjendje të informojnë monitoruesit për gjithë masat që duhen marrë për të siguruar arritshmërinë e plotë.

Lista e plotë e çështjeve që lidhen me përshatshmërinë/ arritshmërinë e aktivitetete për krijimin e kapaciteteve dhe monitorimin:

1. Materialet e printuara (psh., manuallet trajnuese, informacione për procesin monitorues, format e miratuara, pyetësorët)

- Të sigurohen prodhime të materialeve në të gjitha formatet dhe gjuhët e nevojshme për një pjesëmarrje të plotë (psh., alfabet për të verbërit, shkrim të madh, gjuhën e shenjave, formate lehtësisht të kuptueshme dhe të lexueshme)

2. Materiale ndihmese pamore (psh., prezantime në kompjuter, fotografi, grafikë, harta, videokaseta)

- Të sigurohet që një përshkrim i përshtatshëm i informacionit të transmetohet nëpërmjet këtyre materilave ndihmese në një format të pranueshëm (psh., duke siguruar tekstin dhe përshkrimin e imazheve në prezantime kompjuterike)

Lista e plotë e çështjeve që lidhen me përshatshmërinë/ arritshmërinë e aktivitetete për krijimin e kapaciteteve dhe monitorimin(Vazhdim)

3. Komunikimi verbal (psh., ballpërballë, bisedat telefonike, seancat trajnuese, videokasetat, intervistat monitoruese)

- Të sigurohet akordimi i kohës së mjaftueshme dhe përfshirjes së përkthyesit dhe ndihmësit e nevojshëm për të siguruar që personat që janë të me probleme në dëgjim dhe të verbër, me aftësi të kufizuar intelektuale, ose ata që përdorin komunikime shtesë apo alternative, duhet njëkohësisht të kuptojnë çfarë është duke u thënë dhe të mund të komunikojnë për idetë e tyre (psh., interpretimi i gjuhës së shenjave, transkriptim në kohë reale, komunikime ndihmëse)

4. Vendet (psh., për takime, seanca trajnuese, intervista)

- Të sigurohet hyrja për personat që përdorin mjete lëvisëse (psh., të evitohen vendet me shkallë, kalimet e ngushta, dhoma të tejmbushura)
- Të sigurohet mundësia e përdorimit të tualetëve.
- Të sigurohet që pjesëmarrësit të arrijnë në vend me anë transportit të përshtatur me kosto efektive
- Të sigurohen shenja të posaçme në formate të shumfishta, për mundësimin e arritjes së pjesëmarrësve ne destinacion. (psh. shenjat në alfabetin për të verbër Braille)
- Mbani mend të bëni konsulta nga afër me partnerët e (OPAK) (organizatat e personave me aftësi të kufizuar) për të identifikuar kërkesat e nevojshme. Kur është e mundur të bëhen konsulta direkt me personat pjesëmarrës në aktivitet për tu siguruar që kërkesat e tyre të veçanta janë marrë parasysh.

Vini re se këto elementë nuk janë të plotë/ shterues Monitoruesit duhet të drejtojnë arritshmërine e tyre rast pas rasti.

III. Monitorimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar: Përmbledhje.

D. Trajtimi paralel (i njëkohshëm) në monitorimn e Konventës

Monitorimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar kërkon trajtim paralel (të njëkohshëm) ¹²

- Së pari, monitorimi mund të kërkojnë një fokus të veçantë mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuar në mënyrë që të jetë i efektshëm. Për shembull, nqs parlamenti konsideron ratifikimin e konventës, do të ishte e përshtatshme të analizohet në mënyrë specifike nëse kuadri ekzistues ligjor pajtohet me Konventën dhe të monitorojë zbatimin e ligjeve dhe politikave ekzistuese. Në mënyrë të ngjashme, çështjet e veçanta që lidhem me përfshirjen e arsimimit gjithpërfshirës në shkolla, ndërtesa me hyrje të arritshme/të përshtatura për personat me aftësi të kufizuar, kurikula të përshtatshme, mësues me trajnimin e duhur, mund të kërkojnë një aktivitet monitorues të fokusuar mbi të drejtën e arsimimit të nxënësve dhe studentëve me aftësi të kufizuar;

- Së dyti, monitorimi nuk duhet të përforcojë nje qasje që shqyrton personat me aftësi të kufizuar si thelbësisht të ndryshëm nga të tjerët. Rrjedhimisht, monitorimi i të drejtave të tyre duhet të jetë i shkrirë me punën monitoruese të të drejtave të njeriut në përgjithësi. Për shembull, monitorimi i lirisë nga torturat duhet të mbulojë institucionet psikiatrike ashtu si edhe burgjet dhe duhet gjithashtu ti kushtohet vëmëndje personave me aftësi të kufizuar në burgje; monitorimi i një programi zhvillimi duhet të marrë në konsideratë ndikimin e projektit mbi personat me aftësi të kufizuar, si përfitues mbi të njëjtën bazë me grupet e tjera në fokus. Në mënyrë të rëndësishme, shumë institucione kombëtare për të drejtat e njeriut, organizata për persona me aftësi të kufizuar, grupe të tjera të shoqërisë civile dhe zyrat e Kombeve të Bashkuara punojnë në situata konfliktuale ose post-konfliktuale.

¹² Ky term i referohet një qasjeje që kombinon përfshirjen e aftësisë së kufizuar në të gjitha projektet dhe programet e përgjithshme nga njëra anë , me projektet dhe nismat specifike për aftësitë e kufizuara nga ana

tjetër, në mënyrë që të sigurohen të drejta të barabarta për personat me aftësi të kufizuar. Donatorë të ndryshëm kanë përfshirë këtë qasje në politikat e tyre ndërkombëtare për ndihmë dhe zhvillim.

Personat me aftësi të kufizuar mund të jenë veçanërisht të ndjeshëm në këto situata, të vënë përballë sfidave të veçanta, si largim nga situata emergjente ose të lënë mënjanë si rezultat i një konflikti, duke u përballur me pengesa në mjedisin fizik, dhe duke u hequr nga rrjete mbështetjeje personale dhe fizike. Rrjedhimisht, është e rëndësishme të merren në konsideratë të drejtat e tyre në monitorimin e të drejtave të njeriut lidhur me një konflikt, emergjencë apo me një situatë post-konfliktuale.

IV. Monitorimi në praktikë.

Monitorimi përfshin një seri etapash , nga mbledhja e informacionit, në analiza ligjore dhe analiza të informacionit, dokumentim dhe raportim, veprime korigjuese dhe ndjekëse dhe së fundi vlerësime. Këto aktivitete janë të ndërlidhura në të ashtuquajturin cikël monitorues. Ky kapitull fokusohet në: (a) mbledhjen e informacionit; (b) përpunim i të dhënave dhe analizat ligjore; (c) veprimet dokumentuese, raportuese/ korigjuese dhe ndjekëse.

A. Mbledhja e informacionit

1. Informacioni i bazuar mbi dokumentacionet

Mbledhja e informacionit për gëzimin e të drejtave nga personat me aftësi të kufizuar, zakonisht fillon me identifikimin e burimeve të informacionit. Monitoruesit duhet të konsiderojnë një larmi burimesh:

- Kushtetutat, ligjet dhe rregulloret janë burimet primare të informacionit.
Përveç kësaj monitoruesit duhet të konsiderojnë edhe burime të tjera si hetimet apo raportet parlamentare;
- Politikat dhe programet e shteteve në lidhje me zbatimin e legjislacioneve si edhe buxheteve;
- Vendimet e organeve gjyqësore apo gati-gjyqësore, të tilla si gjykatat dhe institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut;
- Raportet mediatike, studimet dhe kërkimet akademike ose të qendrave të tjera kërkimore dhe organizatave të shoqërisë civile.

Monitoruesit mund të mbështeten në burimet e shkruara (psh., mbledhja e dokumentave zyrtare), kërkimet elektronike të legjislacioneve, të dhënat mbi rastet ligjore dhe mekanizmat elektronike të kërkimit për të monitoruar raportimet e medias mbi aftësitë e kufizuara.

Mbledhja e informacionit mbi **legjislacionin**, përfshirë dispozitat kushtetuese, statutet, kodet dhe rregulloret, sigurojnë një mjet për të kuptuar shkallën në të cilën ligjet diskriminojnë personat me aftësi të kufizuara, dhe shkallën në të cilën ata promovojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Mbledhja e informacionit mbi **politikat**- e shteteve strategjitë ose drejtimit që mund të mos jenë domosdoshmërisht bindëse, mund të jenë jetësore për të kuptuar nëse është vullneti politik të lëvizë nga legjislacioni tek zbatimi i Konventës. Në vendet që kanë ratifikuar Konventën, monitorimi i legjislacionit dhe politikave shtron të pakten dy lloje pyetjesh:

- Duke pasur parasysh faktin që kanë adaptuar legjislacionin dhe politikat mbi aftësitë e kufizuara edhe përpara ratifikimit, një hap i parë në monitorim është nëse këto legjislacione dhe politika përputhen me Konventën. Ky rishikim mund të identifikojë boshllëqe normative apo ligjore që janë në konflikt me Konventën, psh duke dhunuar një ndalesë.
- Nëqoftëse legjislacioni dhe politikat përputhen me Konventën, është e rëndësishme të monitorohet se si ato zbatohen faktikisht përmes programesh apo masash të tjera.

IV. Monitorimi në praktikë.

Mbledhja e informacionit mbi **programet** mund të sigurojë që masat praktike dhe financiare, janë në vend për të promovuar realizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar të njohura në legjislacion. Termi "programe" është shumë i gjerë dhe mund ti referohet një numri të madh masash të mara për zbatimin e Konventës. Për shembull, ajo mund ti referohet programeve për zhvillim ose programeve për reduktimin e varfërisë. Në raste të tilla monitoruesit duhet të identifikojnë nëse programe të tilla përfshijnë personat me aftësi të kufizuar dhe janë në mbështetje të të drejtave të tyre.

Për më tepër, monitorimi i programeve duhet të përfshijë monitorimin e buxheteve, pasi disa nga obligimet mbi shtetet kërkojnë akordimin e burimeve financiare dhe njerëzore për të siguruar që të merren hapa pozitivë në promovimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, si dhe që ato të jenë të efektshme.¹³ Analizat e buxhetit mund të jenë të lidhura me çështje të tilla si përshatshmëria, lirshmëria, mbështetja e personave me aftësi të kufizuar, duke përfshirë mbështetjen në vendimmarrje, arsimim gjithpërfshirës, shërbimet mjekësore, mbrojtjen sociale dhe mekanizmat monitorues kombëtar. Monitoruesit e ngarkuar me analizën e buxhetit mund të analizojnë detyrimet financiare në plane kombëtare të veprimit për aftësinë e kufizuar, buxhetet nga ministritë e edukimit, punëve publike apo çështjeve sociale, dhe buxhetin e institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut. Disa pyetje që të vijnë ndërmend gjatë analizës së buxheteve janë:

- A ka ndonjë analizë për kostot financiare të lidhura me realizimin e një të drejte të dhënë për personat me aftësi të kufizuar?

¹³ Shih në përgjithsi, Jim Shultz, "Premtime për tu mbajtur. Duke përdorur buxhetin publik si një mjet për të çuar përpara të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore" (Meksikë, Fondacioni Ford dhe Fundar, 2002); dhe "Dinjiteti vlen. Një guidë për përdorimin e analizës së buxhetit për të çuar përpara të drejtat e njeriut. (Fundar, Instituti i Edukimit Ndërkombëtar dhe Projekti Ndërkombëtar i Buxhetit, 2004).

- A janë caktuar fonde të mjaftueshme për të plotësuar kushtet e vendosura për të kuptuar të drejtën në fjalë?
- Cila është shuma e caktuar në një zonë të caktuar për promovimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, në krahasim me shpenzimet e përgjithshme në atë zonë? Për shembull, çfarë përqindje e buxhetit për arsimin është caktuar për sigurimin e arsimit gjithëpërfshirës për personat me aftësi të kufizuar?
- Cili është ndryshimi midis akordimit të buxhetit dhe shpenzimit të buxhetit? A ka pasur mosshpenzime të buxhetit apo nuk janë plotësuar detyrimet e buxhetit?
- A janë rritur buxhetet me kalimin e kohës?
- A janë caktimet e buxhetit dhe shpenzimet e rezervuara për aftësinë e kufizuar të limituara në ministri apo programe të veçanta?

Mbledhjet dhe studimet e **rasteve ligjore** që përfshijnë çështje që lidhen me personat me aftësi të kufizuar të vendosura nga gjykata, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut, apo organe të tjerë vendimmarrës ligjor, sigurojnë evidenca se si këto organe garantojnë zbatimin e të drejtave, në situata të veçana dhe interpretojnë dhe përforcojnë legjislacionin, politikat dhe programet. Monitorimi i rasteve ligjore mund të sigurojë informacion të vlefshëm për të kuptuar zbatimin e Konventës dhe legjislacionit që lidhet me të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, dhe se si drejtësia është apo jo e pranishme në to. E rëndësishme është gjithashtu të vërehet nëse këto vendime janë ekzekutuar. Për shembull, një trup gjykues mund të ketë lëshuar një urdhër për rivendosjen në punë të një personi me aftësi të kufizuara i cili është pushuar padrejtësisht. Megjithatë nëse punëdhënësi nuk e kujton më këtë person ky i fundit nuk do ta marre dëmshpërblimin.

Raportet mediatike, studimet dhe kërkimet akademike, të qëndrave të tjera kërkimore dhe organizatave të shoqërisë civile mund të jenë shumë të dobishme. Në veçanti mbledhja e informacionit përmes **medias** mund të ndihmojë për të monitoruar sjelljen e shoqërisë kundrejt personave me aftësi të kufizuar.

Sjelljet shoqërore përfaqësojnë një barometër të vlerave sociokulturore dhe influencojnë sesi njerëzit vendosin të veprojnë dhe tu përgjigjen të tjerëve.¹⁴ Në një kontekst të veçantë të aftësisë së kufizuar, qëndrimet negative kanë çuar në stereotipizim, etiketim dhe diskriminim. Këto pikpamje luajnë një rol të rëndësishëm duke lehtësuar apo penguar gëzimin e të drejtave të njeriut nga personat me aftësi të kufizuar. Duke njohur rolin e rëndësishëm social që qëndrimet kanë në perceptimin e personave me aftësi të kufizuar dhe në kontributin e tyre në shoqëri, Konventa i ka dedikuar një artikull të tërë për ngritjen e vetëdijes dhe obligimin e shteteve për të luftuar stereotipet, paragjykimet dhe praktikatat e dëmshme lidhur me personat me aftësi të kufizuar (art.8(1) (a)-(b)).

Duke pasur parasysh rolin e rëndësishëm të medias në reflektimin dhe njëkohësisht influencimin e opinionit publik, Konventa u kërkon shteteve të ndërmarrin hapa për të nxitur të gjitha organet e medias të portretizojnë personat me aftësi të kufizuar në përputhje me qëllimin e Konventës (art. 8 (2) (c)). Në këtë mënyrë, monitorimi i sjelljeve sociale është i rëndësishëm për të kuptuar të drejtat e njeriut në situatën e personave me aftësi të kufizuar.

¹⁴ Tiffany J. McCaughey ang Douglas C. Strohmer, "Prototipet si një masë indirekte e sjelljeve kundrejt grupeve me aftësi të kufizuar", Buletini i Rehabilitimit dhe Këshillimit, vol. 48 No.2 (Janar 2005), fq. 89.

Monitorimi i medias

- A raporton media mbi personat me aftësi të kufizuar?
- Nqs. po, cilat media e bëjnë këtë dhe në cilën pjesë të programacionit të tyre?
- A janë personat me aftësi të kufizuar të portretizuar si viktima apo si mbajtës të të drejtave?
- A paraqesin mediat pikpamjet e personave me aftësi të kufizuar?
- A është gjuha dhe imazhet të përshtatshme?
- Mesazhet e medias a perforcojnë apo janë kundër stereotipeve?
- A janë bërë ndryshime në raportimet e medias kohë pas kohe? Nqs po, në cilën mënyre? (psh., më shumë apo më pak raportime, qasje të ndryshme etj.)? Cilët faktorë kanë kontribuar në ndryshim?
- A është një përfaqësim i saktë i jetës reale?
- A janë mediat të arritshme për personat me aftësi të kufizuar?

IV. Monitorimi në praktikë

2. Burime të tjera informacioni:

"Asgjë për ne, pa ne"

Zakonisht ka një boshllëk të dukshëm ndërmjet dispozitave ligjore dhe politikave në letër, dhe realitetit të përditshëm të njerëzve. Gjithsesi është e domosdoshme që materialet e bazuara mbi dokumentacionin të plotësohen me informacione nga pikpamjet dhe eksperiencat e personave me aftësi të kufizuara. Si pasojë, intervistat kryesore me personat me aftësi të kufizuara, organizatat e tyre përfaqësuese, politikëbërësit, ofruesit e shërbimeve dhe të tjerë, mund të ndihmojnë për të mbledhur informacion se si ligjet dhe politikat janë duke u zbatuar dhe masën në të cilën shtetet respektojnë, mbrojnë dhe përmbushin të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.¹⁵

E rëndësishme për personat me aftësi të kufizuara është që zërat e tyre të dëgjojnë. Monitorimi i përvojave individuale duhet të përqipet të jetë sa më gjithëpërfshirës, duke përdorur strategji për të siguruar që gratë, burrat, vajzat dhe djemtë me gamën e gjerë të aftësive të kufizuara përfshi ato intelektuale, fizike, mendore, dhe ndijore, nga mjedise social- ekonomike dhe etnike të ndryshme, grupmoshave dhe sferave të ndryshme të jetës, popullsisë së ambjenteve urbane dhe rurale, tu jepet mundësia për të qënë pjesëmarrës. Për të adresuar realitetin kompleks me të cilin ata përballen, qëllimi i monitorimit të përvojave të tyre individuale duhet të jetë i gjerë, duke përfshirë një spektër të gjerë të të drejtave civile, kulturore, ekonomike, politike dhe sociale të njeriut, dhe të adresojnë këto çështje si në sferën publike ashtu edhe në atë private.

¹⁵ Puna me personat me aftësi të kufizuara, dhe me organizatat e tyre përfaqësuese në vende të ndryshme, Promovimi Ndërkombëtar i të Drejtave të Personave me aftësi të kufizuara (DRPI) ka zhvilluar një rigë/vizore "shabllon" për të asistuar me mbledhjen e legjislacionit, politikave dhe programeve të specifikuara për personat me aftësi të kufizuara. Kjo rigë (template) është dizenuar për të grumbulluar të dhëna për të gjitha kategoritë e të drejtave (civile, kulturore, ekonomike, politike dhe sociale). Kjo shërben gjithashtu edhe si një mjet vlerësimi për të lehtësuar identifikim e boshllëqeve në legjislacion dhe politika. Ajo përfshin referenca për dispozitat përkatëse të traktateve kyçe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, duke përfshirë dhe Konventën. Kjo është e disponueshme në ëbsite-in e DRPI:<http://ëëë.yorku.ca/drpi/resources.html>

Mënyra më efektive për monitorimin e përvojave individuale është përmes intervistave ballpërballë. Intervistat mund të japin të dhëna sasiore dhe cilësore, përderisa personave me aftësi të kufizuar u është dhënë mundësia për të folur dhe identifikuar çështjet që janë më të rëndësishme për ta, në termat e mohimit dhe lejimit të të drejtave të tyre.¹⁶

Monitoruesit duhet të përftojnë **lejen e lirë dhe të informuar** të të intervistuarve, duke pasur parasysh historinë e gjatë të kërkimeve mbi personat me aftësi të kufizuar pa pëlqimin e tyre. Monitoruesit duhet gjithashtu të ruajnë privatësinë dhe sigurinë e të intervistuarve si dhe **konfidencialitetin** e informacionit të siguruar kur kjo është e domosdoshme. Në vartësi të situatës, intervistat mund të zhvillohen pa praninë e pjesëtarëve të familjes, kujdestarëve apo personave të tjerë, në një vend ku biseda të mos përgjohet. Anëtarët e familjes, kujdestarët, dhe persona të tjerë mund të jenë përgjegjës për dhunimet e të drejtave të njeriut të përjetuara nga personat me aftësi të kufizuar, (psh., kur personi tjetër është përgjegjës për abuzim fizik ose psikologjik ndaj një personi me aftësi të kufizuar, apo kur e ndalon personin me aftësi të kufizuar të dalë nga shtëpia për të shmangur turpin e pasjes një person me aftësi të kufizuar në familje). Është e rëndësishme që i intervistuari të flasë lirisht pa pasur frikë se ndëshkohet.

¹⁶ Në bashkëpunim me organizatat partnere të personave me aftësi të kufizuar, DRPI ka zhvilluar mjete monitoruese (udhëzues interviste dhe të tjera dokumente për terren) dhe materiale trajnuese (kurse trajnimi dhe materiale mbështetëse) për të lehtësuar mbledhjen, analizimin dhe raportimin në intervista të tilla. Këto materiale janë të disponueshme në ëbsite-in: <http://ëëë.yorku.ca/drpi/>

IV. Monitorimi në praktikë

3. Puna me personat me aftësi të kufizuar

Gjatë moniotrimimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar duhen mbajtur mend dy çështje të përgjithshme thelbësore. Së pari, mbani mend që qëllimi kryesor është të monitorojmë **të drejtat** e personave me aftësi të kufizuar dhe jo **aftësinë e kufizuar**. Këshu që monitoruesit duhet të pyesin se çfarë shoqëria ka bërë ose jo në pengimin e gëzimit të të drejtave të tyre dhe jo se si dëmtimet e tyre fizike apo mendore kanë ndikuar në gëzimin e të drejtave të tyre. Për shembull, kur monitorojmë të drejtën për arsim, kini parasysh që mësues me trajnim të dobët, sjelljet negative dhe paragjykimet ose shkollat e papërshtatura, janë arsye të mundshme që personat me aftësi të kufizuar të mos gëzojnë të drejtën e arsimimit të plotë, më tepër se sa të qenit të tyre të verbër, me probleme në dëgjim apo me aftësi të kufizuara psikosociale.

Së dyti, kujtoni që duhet të punoni drejtpërdrejt me personat me aftësi të kufizuar. Duke marrë parasysh padukshmërinë e personave me aftësi të kufizuar në shumë shoqëri, kërkonit asistencën e organizatave përfaqësuese për mundësimin e takimeve me këta persona. Për më tepër, është e rëndësishme të flisni direkt me personat me aftësi të kufizuar, jo me kujdestarët, profesionistët e shëndetësisë, familjarët, apo me ata persona që pretendojnë se flasin në emër të tyre. Komunikimi direkt me personat mund të sjellë nevojën e përdorimit të pajisjeve ndihmëse si gjuhën e shenjave ose persona mbështetës interpretues. Prandaj është e rëndësishme që monitoruesi të jetë i vetdijshëm që mesazhi i të intervistuarit mund të jetë jo i saktë, i komunikuar jo plotësisht ose i keqkuptuar (psh., bëni kujdes në marrëdhënien që ekziston ndërmjet personit mbështetës dhe individit, dhe familjaritetit të këtij individit me mekanizmat apo pajisjet ndihmëse).

Nëqoftëse kujdestarët apo persona të tjerë janë shok të besueshëm, ata mund të jenë në gjendje të na japin informacion të paçmueshëm por është e rëndësishme të moe e marrim këtë si të mirqënë. Disa persona që pretendojnë se kujdesen për persona me aftësi të kufizuar mund që qëllimisht ose jo të kontribuojnë në abuzim.

Pjesa tjetër e paragrafit na jep disa rregulla të mirësjelljes veçanërisht kur intervistojmë persona me aftësi të kufizuar.¹⁷

¹⁷Materiali është përshtatur nga Victor Piñeda, "Portretizimi në media i personave me aftësi të kufizuar", Landmine Survivors Network Media Advocacy Handbook (Instituti Mediatik për Aftësinë e kufizuar, 2006)

IV. Monitorimi në praktikë

Përgjithsisht...

- Shtrengoni duart kur prezantoheni me një person me aftësi të kufizuar, nqs shtrengimi i duarve është i mundur. Personat me mungesë të gjymtyreve apo me proteza i shtrengojë duart;
- Flisni direkt me personin jo përmes shoqëruesit të tyre;
- Gjuha është e rëndësishme. Shmangni shprehje të tilla si "aftësi e kufizuar", "handikapat", "viktimë", "goditur me", "invalid", "normal", "pacient" ose "i varur pas karrocës". Shmangni mbipërdorimn e fjalëve të tilla si "i guximshëm", "trim" apo "frymëzues". Terminologjia e pranuar në Konventë është "persona me aftësi të kufizuar", jo "persona me paaftësi"; "të drejtat e personave me aftësi të kufizuar", jo "të drejtat e paaftësisë". Konventa përdor termat "aftësi e kufizuar mendore" dhe "aftësi e kufizuar intelektuale" edhe pse disa preferojnë termin "aftësi e kufizuar psikosociale". Nqs një person me aftësi të kufizuar preferon të përdorë një terminologji të tillë, respektoni vullnetin e tij, përveçse kur ajo mund të konsiderohet përçmuese ose minuese e dinjitetit të tij;
- Mos u ndjeni në siklet në përdorimin e shprehjeve të tilla si " E kuptoj çfarë doni të thoni" ose "E dëgjoj çfarë jeni duke thënë", "Kaloni nga kjo anë" ose "Më duhet të iki, jam vonë". Këto janë shprehje të zakonshme dhe ka pak gjasa që të merren për ofezë;
- Nëqoftëse ofroni ndihmë, prisni derisa oferta juaj të pranohet;
- Merrni në konsideratë nevojat e personave përpara se të zhvilloni takimin. Nqs personi është në karrike me rrota, përpquni të gjeni një dhomë me ramp/plan të pjerrët në hyrje. Nqs personi është i shoqëruar, gjeni një dhomë me hapësirë të mjaftueshme për persona shtesë;
- Drejtojeni intervistën në atë mënyrë që të fokusohet më tepër në gëzimin e të drejtave se sa në aftësinë e kufizuar;
- Mos e merni për të mirëqënë ose mos veproni sikur personat me aftësi të kufizuar janë të guximshëm apo heronj thjesht duke pasur një aftësi të kufizuar. Kjo thekson ndryshim. Personat me aftësi të kufizuar kanë forca dhe dobësi njësoj si personat pa aftësi të kufizuara.

Gjatë intervistimit të personave me vështirësi në dëgjim apo të shurdhër...

- Të tërheqësh vëmëndjen e personit, duke e prekur lehtë mbi shpatull apo duke e tundur;
- Të përdorim përkthyes të gjuhës së shenjave kur i intervistuari është përdorues i gjuhës së shenjave;
- Ti drejtohem personit drejtpërdrejt, jo përkthyesit;
- Nqs jeni duke intervistuar një person me vështirësi në dëgjim, pyeteni se ku do të ishte më e përshtatshme për të që të uleshit;
- Nqs personi mund të lexojë buzët, shikoni drejt tij ose saj dhe flisni ngadalë dhe qartë. Mos e ekzagjeroni lëvizjen e buzëve dhe mos bërtisni. Jini ekspresiv, shprehjet e fytyrës, gjestet dhe gjuha e trupit do ti ndihmojë për t' ju kuptuar;
- Pozicionohuni përballë burimit të dritës dhe mbajini duart larg ushqimeve apo gojës kur jeni duke folur.

Kur intervistoni persona me aftësi të kufizuar pamore....

- Gjithmonë prezantoni veten tuaj dhe këdo tjetër që do të jetë prezent në intervistë;
- Kur doni të shtrengoni duart pyesni " a mund të shtrengojmë duart?";
- Kur ofroni për tu ulur, vendosni dorën e personit në anën e pasme apo në krahun e ndenjës;
- Bëjeni personin me dije nëse doni të lëvizni apo keni nevojë të mbyllni bisedën;
- Merrni parasysh nëse personi mund të kërkojë informacion në Braille ose ndonjë akomodim fizik specifik, nqs intervista nuk zhvillohet në ambientin e tyre
(Numrat Braille në ashensor, ngjyra të kundërta për hapat e kështu me rradhë).

Kur intervistohen persona me aftësi të kufizuar në të folur...

- Bëni pyetje të shkurtra dhe kërkonte përgjigje të shkurtra nëse është e mundur;
- Mos u shtirni sikur kuptoni. Provoni të përsërisni pyetjen nëse është e nevojshme;
- Është e nevojshme të sigurohet një përkthyes i gjuhës së shenjave ose të mbulohen shpenzimet e përkthyesit të të intervistuarit;

Kur intervistohen persona që përdorin karrike me rrota ose paterica...

- Mos u përkulni në një person në karrike me rrota. Karrikja është pjesë e hapësirës së tij trupore e personale;
- Nëse është e mundur uluni, në të kundërt vendosuni në një pozicion pamor në të njëjtin nivel me të intervistuarin;
- Sigurohuni që vendndodhja e intervistës të jetë e përshtatshme. Kontrolloni për:
 - Parkim të rezervuar për personat me aftësi të kufizuar
 - Hyrje me një plan të pjerrët/ ramp
 - Tualete të përshtatura
 - Ashensor, nëse intervista nuk zhvillohet në katin e parë
 - Frigorifer uji dhe telefona të ulët për tu aritur nga personat që përdorin karrike me rrota
- Njoftoni të intervistuarin më përpara nëse ka ndonjë problem me vendndodhjen. Diskutojini pamundësitë me të intervistuarin dhe bëni plane alternative nëse është e nevojshme.

Kur intervistohen persona me aftësi të kufizuar intelektuale...

- Caktoni kohë të mjaftueshme për intervistën;
- Flisni qartë, përdorni gjuhë të plotë, shpjegoni termat teknik, dhe riformuloni pyetjen tuaj nëse është e nevojshme;
- Bëni pyetje të shkurtra por preçize dhe qartësoni kërkesat/ nevojat;
- Konsideroni më përpara nëse personi mund të kërkojë informacion në formate të arritshme, për shembull duke kthyer dokumentet në një gjuhë të thjeshtë, duke përdorur piktura ose vizatime, etj. Punët e shtypura duhet të jenë me shkronja të mëdha dhe me hapësirë të dyfishtë;
- Nëse i intervistuari ka një person mbështetës:
 - Adresojani intervistën direkt atij dhe jo personit mbështetës
 - Pyeteni të intervistuarin nëse mund ti drejtoni pyetje personit mbështetës nëse është e nevojshme
 - Kërkojini personave mbështetës të jenë pjesëmarrës, por qartësoni që ata nuk duhet të influencojnë tek i intervistuari.

IV. Monitorimi në praktikë

B. Analizë Ligjore dhe përpunim informacioni

Pasi monitoruesit të kenë mbledhur informacione duhur, hapi tjetër është të analizojnë nëse shtetet kanë plotësuar detyrimet e tyre lidhur me të drejtat e personave me aftësi të kufizuar. Për të bërë këtë është e dobishme të bëhen referenca për obligimet për të **respektuar, mbrojtur dhe përmbushur** të drejtat e vendosura në Konventë. Paragrafi i mëposhtëm sjell disa shembuj sesi të monitorohen disa nga të drejtat e personave me aftësi të kufizuar në këtë drejtim. Është e rëndësishme të vihet re që kjo është një liste ilustruese dhe jo e plotë. Monitoruesit duhet të marrin kohë për të lexuar nenet përkatëse të Konventës dhe të aplikojnë kornizën "respekto/mbro/përmbush" në përputhje me rrethanat.

1. E drejta e njohjes së barabartë para ligjit dhe mundësitë ligjore

Pyetje e përgjithshme e monitorimit:

A e gëzojnë personat me aftësi të kufizuara mundësinë e tyre ligjore për të vepruar?

Detyrimi për të respektuar:

Shembull: Nënpunësit e të drejtave të njeriut të Kombeve të Bashkuara monitoruan një rast në të cilin një gjyqtar përjashtoi nga dhënia e dëshmisë një grua me aftësi të kufizuara e cila pretendonte të kishte qenë viktimë e dhunës seksuale. Gjyqtari argumentoi se ajo nuk përbënte një burim të sigurt duke marrë parasysh aftësinë e kufizuar. Ky veprim nga ana e gjyqtarit është një dhunim i qartë i detyrimit të shtetit për të respektuar.

- A ka një garanci ligjore që njeh të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të gëzuar kapacitetin e tyre ligjor mbi baza të barabarta me të tjerët?
- A ka përjashtime në këtë garanci ligjore e cila mund të diskriminojë, për shembull në bazat e aftësisë së kufizuar mendore apo ndonjë tjetër? (Psh., dispozitat mund të referohen për përjashtime për personat "me mendje të sëmurë" ose (që janë të papërgjegjshëm").)
- A ka një mekanizëm ligjor përmes së cilit personat me aftësi të kufizuara janë plotësisht apo pjesërisht të privuar nga mundësitë e tyre ligjore për të vepruar në bazë të afësisë së kufizuar të tyre? (psh., një proces ligjor në të cilin është vendosur një person tjetër për të përfaqësuar dhe vepruar në vend të një personi me aftësi të kufizuara, me kujdestari të plotë apo të pjesshme.)
- A i lejon ligji personat me aftësi të kufizuara të angazhohen me veprime ligjore në baza të barabarta me të tjerët? (Psh., martesat; divorci; hapja e llogarive bankare; marrjen e kredive bankare; hipotekat dhe forma të tjera të kreditit financiar; votimi; mbrojtja e të drejtave të tyre në gjykatë; të paraqiten si dëshmitarë në procese gjyqësore; zotërimi apo trashëgimi i pronës; bërja e testamenteve; kontrolli i trajtimeve të tyre mjeksore.)

IV. Monitorimi në praktikë

1. Njohja e të drejtave të barabarta para ligjit dhe mundëistë ligjore

Detyrimi për të mbrojtur:

- Si i mbron Shteti personat me aftësi të kufizuar nga abuzimet në të drejtat e tyre për të ushtruar kapacitetet e tyre ligjore? A ka vendosur Shteti masa mbrojtëse të duhura dhe efektive për të parandaluar abuzimet e mbështetjes së dhënë për personat me aftësi të kufizuar në ushtrimin e kapaciteteve të tyre ligjore?
- Çfarë rishqyrtimi apo korigjimi është i disponueshëm për personat me aftësi të kufizuar nëse e drejta për të ushtruar kapacitetin ligjor u mohohet. (Psh., nqs një ofrues shërbimesh refuzon të pranojë shprehjen e vullnetit si të vlefshme; nqs kërkohet pëlqimi i një pjestari të familjes apo kujdestari në të gjitha rrethanat për një person me aftësi të kufizuar për të marrë trajtim mjeksor.)

Obligimi për të përmbushur/plotësuar:

- A ka nxjerrë Shteti ligje, politika dhe programe përfshirë mekanizmat e njohur ligjërisht, për tu ofruar personave me aftësi të kufizuar mbështetjen që mund tu duhet për ushtrimin e kapaciteteve të tyre ligjore?
- A u ofron Shteti mbështetje personave me aftësi të kufizuar kur kërkojnë të marrin pjesë drejtpërdrejt në proceduar ligjore, dhe të ushtrojnë kapacitetin e tyre ligjor për të vepruar, duke përfshirë lehtësimin e gjuhës së shenjave, Braille apo një gjuhë të thjeshtë? Apo ata lejohen të jenë pjesëmarrës vetëm nëpërmjet kujdestarëve të tyre ligjor?

Shembull: Monitoruesit kanë dokumentuar raste në të cilat personat me aftësi të kufizuar janë detyruar me forcë për të jetuar në institucione. E drejta për të jetuar në mënyrë të pavarur, kërkon nga Shtetet që të sigurojnë akses për personat me aftësi të kufizuar tek shërbimet komunitare dhe rezidenciale, duke mbështetur jetesën e pavarur në komunitet. Dështimi për të bërë këtë përbën një shkelje të detyrimit për të përmbushur.

2. Jetesa e pavarur dhe përfshirja në komunitet

Pyetje të përgjithshme monitoruese:

A e kanë personat me aftësi të kufizuar të drejtën për të jetuar në komunitet me zgjedhje të barabarta me të tjerët?

Detyrimi për të respektuar:

- A ekzistojnë mbrojtje ligjore që njohin të drejtën e personave me aftësi të kufizuar për të zgjedhur banesën e tyre dhe ku dhe me kë ata duan të banojnë në baza të barabarta me të tjerët?
- A ekzistojnë mbrojtje ligjore që sigurojnë që personat me aftësi të kufizuar nuk detyrohen të jetojnë në mjedise të caktuara?

Detyrimi për të mbrojtur:

- A ekzistojnë mbrojtje ligjore që sigurojnë që personat me aftësi të kufizuar nuk detyrohen forcërisht nga persona të familjes apo persona të tjerë për të jetuar në mjedise të veçanta?
- A ka mekanizma ligjorë dhe mjete juridike që personat me aftësi të kufizuar mund të përdorin për të sfiduar barrierat për të jetuar në mënyrë të pavarur?
- A ka marrë Shteti masa për të forcuar dhe monitoruar zbatimin e të drejtës për të jetuar të pavarur në komunitet?

Detyrimi për të plotësuar/përmbushur:

- A ka ligje, politika dhe programe që sigurojnë për personat me aftësi të kufizuar akses në shërbimet komunitare duke përfshirë asistencën personale dhe mbështetjen e nevojshme për tu përfshirë në komunitet.
- A ka ligje, politika dhe programe që sigurojnë se shërbimet komunitare dhe lehtësirat për publikun e gjerë, bëhen të disponueshme në baza të barabarta për personat me aftësi të kufizuara dhe që u përgjigjen nevojave të tyre?

3. Arritshmëria/ Përshtatshmëria:

Pyetje e përgjithshme monitoruese:

A e gëzojnë personat me aftësi të kufizuara në të njëjtat baza me të tjerët mjedisin fizik, transportin, teknologjite e komunikimit dhe informacionit dhe sisteme apo shërbime të tjera ndihmëse të hapura për publikun e gjerë?

Detyrimi për të respektuar:

- A ekzistojnë mbrojtje ligjore që sigurojnë aksesin në baza të barabarta me të tjerët në mjedisin fizik, transportin, teknologjite e komunikimit dhe informacionit dhe sisteme apo shërbime të tjera ndihmëse të hapura për publikun e gjerë?
- A zbatohen standaret dhe direktivat minimale njëkohësisht si në zonat urbane dhe në ato rurale?
- A është Shteti i angazhuar në ndonjë veprim apo praktikë që krijon barriera për arritshmërinë/ përshatshmërinë?

Barrierat për arritshmërinë mund të marrin shumë forma, përfshi ato:

- **fizike** - barrierat në mjedis, veçanërisht ato në infrastrukturë (psh., tualetet publike janë shumë të vogla për karriket me rrota);
- **informative** - barrierat mund të lindin njëkohësisht nga forma dhe përmbajtja e informacionit (psh., dokumentet elektronike që nuk mund të lexohen pa monitor nuk janë të arritshme për personat e verbër; informacionet që nuk janë në një gjuhë të thjeshtë nuk janë të arritshme nga personat me aftësi të kufizuara intelektuale; informacionet verbale që nuk janë të disponueshme në gjuhën e shenjave apo që nuk mundësojnë një përkthyes në gjuhën e shenjave, nuk janë të arritshme për personat me probleme në dëgjim).

3. Arritshmëria (vazhdim.)

Detyrimi për të mbrojtur:

- A ka ndërmarrë Shteti veprime ligjgjore për të siguruar që subjektet private (psh., restorantet, teatrot, dyqanet ushqimore, shoqëritë e taksive dhe biznese të tjerë, që ofrojnë lehtësira dhe shërbime për publikun) i heqin pengesat ekzistuese të arritshmërisë për personat me aftësi të kufizuar, dhe nuk krijojnë të reja?
- A ka mjete apo mekanizma ligjorë që personat me aftësi të kufizuar mund të përdorin kur arritshmëria nuk është e mundur?
- A ka marrë Shteti masa për të forcuar dhe monitoruar zbatimin e standarteve dhe udhëzimeve minimale të arritshmërisë?

Detyrimi për të plotësuar/përmbushur:

- A siguron Shteti trajnime për palët e interesuara për arritshmërine për personat me aftësi të kufizuar?
- A ka marrë Shteti hapa për të siguruar shenja në Braille (alfabet për të verbërit) formate lehtësisht të lexueshme dhe kuptueshme dhe tipe të tjerë ndihmës ose ndërmjetës të drejtpërdrejtë (psh., udhëzues, lexues dhe përkthyes së gjuhës së shenjave)?
- A ka marrë Shteti masa për të promovuar aksesin në teknologjitë dhe sistemet e reja të komunikimit dhe informacionit përfshi Internetin, në një fazë të hershme?

IV. Monitorimi në praktikë

4. E drejta për arsimim

Pyetje e përgjithshme monitoruese:

A kanë personat me aftësi të kufizuar akses për arsimim gjithpërfshirës në të gjitha nivelet?

Detyrimi për të respektuar:

- A e njeh legjislacioni qartësisht të drejtën për arsimim gjithpërfshirës?
- A i refuzon shteti studentët me aftësi të kufizuar për të hyrë në sistemin e përgjithshëm arsimor?
- A mban Shteti një sistem të ndarë shkollash të cilën studentët me aftësi të kufizuar janë të detyruar të frekuentojnë?
- A janë studentët me aftësi të kufizuar të detyruar të ndjekin lëndë të veçanta ose janë përjashtuar nga marrja e klasave të caktuara në bazë të aftësisë së tyre të kufizuar?
- A u kërkohet studentëve me aftësi të kufizuar ti nënshtrohen ndonjë trajtimi mjekësor si një kusht për tu pranuar në shkollë?

Detyrimi për të mbrojtur:

- A ka përshtatur Shteti masa legjislative për të parandaluar përjashtimin e personave me aftësi të kufizuar nga sistemi i përgjithshëm i arsimit?
- A u kërkon Shteti objekteve private të edukimit të marrin hapa për të siguruar aksesin në kushtet dhe teknologjinë e tyre me qëllim për të hequr pengesat për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar në sistemin arsimor?

4. E drejta për arsimim (vazhdim)

Detyrimi për të plotësuar/përmbushur:

- A vuajnë vajzat me aftësi të kufizuar diskriminim e shumfishtë për të gëzuar të drejtën e tyre për arsimim?
- A ka ndërmarrë shteti hapa për të siguruar mbështetje, përfshi mbështetje individuale për studentët me aftësi të kufizuar, në përputhje me qëllimin e arsimimit gjithëpërfshirës?
- A ka marrë Shteti hapa për të siguruar aksesin në shkolla, pajisje të tjera edukative apo në teknologji?
- A ka marre Steti hapa për të punësuar mësues, përfshi mësues me aftësi të kufizuar, që janë të kualifikuar në gjuhen e shenjave apo Braille?
- A siguron dhe kërkon Shteti trajnimin e mësuesve dhe profesionistëve të tjerë që mund të ndihmojnë në sigurimin e arsimimit gjithëpërfshirës?

IV. Monitorimi në praktikë

5. E drejta për lirinë dhe sigurinë e personit

Pyetje e përgjithshme monitoruese:

A janë personat me aftësi të kufizuar të privuar nga liria në bazë të aftësisë së tyre të kufizuar?

Detyrimi për të respektuar:

- A kanë personat me aftësi të kufizuar të drejtën e lirisë dhe sigurisë në baza të barabarta me të tjerët?
- A e lejon ligji heqjen e lirisë (në burgje, institucione psikiatrike apo struktura të tjera) në llogari të një personi që ka një aftësi të kufizuar, qoftë vetëm ose në kombinim me faktorë të tjerë ?

Detyrimi për të mbrojtur:

- A i ndalon Shteti palët e treta si pjesëtarët e familjes, që ti dërgojnë në institucione personat me aftësi të kufizuar në bazë të aftësisë së tyre të kufizuar?
- A i kompeson Shteti personat me aftësi të kufizuara të cilët janë privuar nga e drejta e lirisë, për shkak të aftësisë së tyre të kufizuar?

Detyrimi për të plotësuar/përmbushur:

- A siguron Shteti strehim/akomodim të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuar të cilët janë privuar nga liria e tyre ligjërisht? (psh., si rezultat i një procedure kriminale)?

Monitorimi i lirisë nga shfrytëzimi, dhunës nga abuzimi

Duke marrë parasysh abuzimet që personat me aftësi të kufizuar kanë vuajtur në institucione dhe përmes shërbimeve që formalisht duhet tu shërbejnë atyre, si institucionet e shëndetit, neni 16 mbi "lirinë nga shfrytëzimi, dhuna dhe abuzimi" kërkon në mënyrë specifike nga Shtetet monitorimin e programeve dhe objektivave:

"3. Me qëllim që të parandalojnë shfaqjen e të gjitha formave të shfrytëzimit, dhunës dhe abuzimit, shtetet palë duhet të sigurojnë që të gjitha objektivat dhe programet e hartuara për personat me aftësi të kufizuar, të monitorohen me efektivitet nga autoritete të pavarura.

C. Raportimi dhe ndjekja

Cikli i monitorimit përfshin gjithashtu dokumentimin dhe raportimin si dhe veprime korrigjuese dhe ndjekje. Gjatë këtyre dy hapave, është e rëndësishme të merret parasysh parimi i pjesëmarrjes dhe motoja e personave me aftësi të kufizuar dhe e organizatave të tyre përfaqësuese. "Asgjë për ne, pa ne". Kjo do të thotë që, ku është e praktikueshme, monitoruesit duhet të kontrollojnë me personat me aftësi të kufizuar dhe më organizatat e tyre përfaqësuese që raportimi ka përmbledhur në mënyrë adekuate dhe të saktë situatën e të drejtave të njeriut dhe se si ajo ndikon në individët dhe se ato janë gjerësisht në marrëveshjet me rekomandimet për veprimet korrigjuese. Kjo është e rëndësishme, duke pasur parasysh përfshirjen e qartë të parimit të pjesëmarrjes në Konventë, dhe faktin se personat me aftësi të kufizuar kanë qenë prej shumë kohësh të përjashtuar nga procesi i vendimarrjes që ndikon mbi ta. Monitoruesit duhet gjithashtu të jenë të vetdijshëm për dallimin ndërmjet organizatave të personave me aftësitë kufizuar (OPAK) dhe OJQ-ve që punojnë për aftësinë e kufizuar, duke përfshirë dhe ofruesit e shërbimeve. Konsideratë e kujdesshme i duhet dhënë pozicionit të (OPAK), veçanërisht nëse organizatat kanë pikpamje të dallueshme.

IV. Monitorimi në praktikë

Megjithatë, monitoruesit duhet të peshojnë pjesëmarrjen e domosdoshme me problemet praktike dhe politike të punës për të drejtave të njeriut. Për shembull, në kontekstin e prezencës së Kombeve të Bashkuara në fushën e të drejtave të njeriut, ajo mund të jetë e përshtatshme në disa raste që raportet monitoruese të qëndrojnë të brendshme për një periudhë kohe. Ndonjëherë mund të ketë mosmarrëveshje me organizatat e personave me aftësi të kufizuar për përmbajtjen e raportit apo për hapat e veprimeve korrigjuese dhe ndjekëse. Është gjithmonë e rëndësishme që të kujtohet që ndërsa pjesëmarrja mbetet qëllimi i përgjithshëm, organizata ndërmarrëse e monitorimit është në fund të fundit përgjegjëse për përmbajtjen, konkluzionet dhe rekomandimet e raportit.

Monitoruesit gjithsesi duhet të arrijnë një ekuilibër ndërmjet parimit të pjesëmarrjes dhe respektimit të mandatit, konfidencialitetit të të dhënave dhe dëshmitarëve, dhe mbrojtjes së viktimave. Vështirësitë e këtij procesi nuk duhet të nënvlerësohen meqënëse ka një prirje shumë të lartë nga ana e personave me aftësi të kufizuar dhe organizatave të tyre për përfshirjen në këtë proces. Monitoruesit mund të konsiderojnë dokumentimin e procesit e pjesëmarrjes dhe të sigurojnë që janë dhënë arsye adekuate për të mbështetur konkluzionet dhe rekomandimet e tyre për veprimet korrigjuese.

Bibliografi e zgjedhur

Publikime dhe raporte

Unioni Afrikan i të Verbërve. Gjendja e personave me aftësi të kufizuar në Kenia: Raport. Nairobi, 2007. fq.130.
E disponueshme në: ëëë.yorku.ca/drpi

Unioni Afrikan i të Verbërve dhe Shoqata Kombëtare për të Verbërit, Kamerun. Studime për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar në Kamerun. 2007. Fq. 146.
E disponueshme në: ëëë.yorku.ca/drpi

Degener, Theresia. Aftësia e kufizuar si një temë e të drejtave ndërkombëtare të njeriut: ligji për diskriminimi Të drejtat e personave me aftësi të kufizuar intelektuale: Të ndryshëm por të barabartë. Nga Herr, S., L. Gostin dhe H. Koh, eds. Oksford, Shtypi i Universitetit të Oksfordit, 2003, fq. 151-184.

Promovimi Ndërkombëtar i të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar. Faza 1 raport: Mundësitë, metodologjitë dhe burimet trajnuese për monitorimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar. Promovimi Ndërkombëtar i të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar, Toronto, 2003, fq. 70.
E disponueshme në: <http://ëëë.yorku.ca>

Të drejtat e njeriut. Po! Veprime dhe përkrahje të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar. Nga Lord, J. dhe të tjerë. Qendra Burimore e të Drejtave të Njeriut, Mineapolis, Universiteti i Minesotës, 2007. (Të Drejtat e Njeriut, seri librash edukativ 6)
E disponueshme në: <http://ëëë.umn.edu>

Katipunan ng Maykapansanan sa Pilipinas, Inc. dhe Promovimi Ndërkombëtar i të Drejtave të Njeriut. Monitorimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar; Raport paraprak, Filipine 2009.

E disponueshme në: www.yorku.ca/drpi/resources.html

Lingvist, B., M. Rioux dhe R. Samson. Të ecësh përpara: Progresi në monitorimin global të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar. Promovimi Ndërkombëtar i të Drejtave të Aftësisë së Kufizuar, Toronto 2007.

E disponueshme në: <http://www.yorku.ca>

Oliver, Michael. Politikat e Aftësisë së kufizuar.

Basingstoke, Macmillan, 1990.

Quinn, G. dhe T. Degener. Të drejtat e njeriut dhe aftësia e kufizuar: Përdorimi aktual dhe e ardhmja e mundshme e instrumentave të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut në kontekstin e aftësisë së kufizuar. Kombet e Bashkuara, Neë York dhe Gjenevë, 2002. (HR/PUB/02/1)

E disponueshme në: <http://www.ohchr.org>

Rioux, Marcia. Një mendim i dytë: ndërtimi i njohurive, ligjet, aftësia e kufizuar dhe pabarazia, në të drejtat e personave me aftësi të kufizuar intelektuale: Të ndryshëm por të barabartë. Nga Herr S., L. Gostin dhe H. Koh, eds. Shtypi i Universitetit të Oksfordit, Oksford 2003, fq. 287-317.

UNICEF dhe Fondacioni Victor Piñeda. Në lidhje me aftësinë: Një shpjegim për Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar. UNICEF, Neë York 2008.

E disponueshme në: <http://www.unicef.org>

_____ Në lidhje me aftësinë: Udhëzues mësimi mbi Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar. UNICEF, Neë York 2009.
E disponueshme në: <http://ëëë.unicef.org>

Kombet e Bashkuara, Zyra e Komisionerëve të lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut dhe Unioni Ndër-Parlamentar. Nga përjashtimi në barazi: Kuptimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar. Manual për parlamentarët. Kombet e Bashkuara, Gjenevë 2007. (Trajnim profesional seria Nr. 14)
E disponueshme në: <http://ëëë.ohchr.org>

Kombet e Bashkuara. Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar: Toolkit, Mbrojtje, 2008.
E disponueshme në: <http://ëëë.ohchr.org>

Dokumentat zyrtarë të Kombeve të Bashkuara
(Të disponueshme në: ëëë.ods.un.org)

Asambleja e Përgjithshme, Kombet e Bashkuara. Studim Tematik, nga Zyra e Komisionerëve të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, në rritjen e vetëdijes dhe të kuptuarit të Konventës së të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar. (A/HRC/10/48)

_____ Raport i përkohshëm i Reporterëve Special mbi torturën dhe trajtime dhe ndëshkime të tjera mizore, antihumane dhe degraduese. (A/63/175)

_____ Raportii Komisionerëve të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Progresin në të Drejtat e Njeriut për zbatimin e rekomandimeve të përfshira në

studimin mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuar. (A/HRC/4/75)

Faqe interneti

Kombet e Bashkuara, mundësojnë: <http://ëëë.un.org/disabilities/>

Zyra e Komisionerëve të lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut:
<http://ëëë.ohchr.org/>